



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 258/ 12 Prot.

Tiranë, më, 26/07/2017

V E N D I M

Nr. 88, Datë 26/07/2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KAVAJË "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", të ushtruar në Bashkinë Kavajë për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2016 dhe ish-Komunat Golem, Helmas, Synej, Luzi i Vogël për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur*

në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse (vendimet ekzekutive), si edhe **nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim sistemimin, likuidimin e vlerave në shumën **165,090,915 lekë**, veçanërisht arkëtimin e të ardhurave të munguara nga taksat vendore në vlerën **82,623,314 lekë**, si më poshtë: **(31,522,219 lekë +23,384,315 lekë) Rekomandimet e mëparshme + 82,623,314 lekë taksa + 23,119,120 lekë nga qeraja e asete ujra, kullota rere).**

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në Bashkinë Kavajë, **lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditit të mëparshëm të KLSH-së**, rezulton se me shkresën nr. 226/9, datë 31.08.2015, sipas Vendimit nr. 107, datë 31.08.2015 të Kryetarit të KLSH-së janë rekomanduar:

28 masa organizative (me vlerën **30,003,092 lekë**), nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 masa, në proces 10 masa me vlerën 5,432,821 lekë dhe pa zbatuar 16 masa me vlerën 23,384,315 lekë prej të cilës masa organizative–zhdëmtuese nr. 1 a,b me vlerën **15,230,092 lekë nuk është urdhëruar e nuk është përfshirë për zbatim ne urdhrin nr. 121, datë 9.11.2015 te Kryetarit të Bashkisë.**

25 masa shpërblim dëmi (me vlerën **32,839,607lekë**) nga të cilat, janë zbatuar plotësisht 1 masë me vlerën 220,000lekë, pjesërisht 3 masa me vlerën arkëtuar 1,097.388 lekë dhe nuk janë zbatuar 21 masa zhdëmtuese me vlerën 31,522,219 lekë. Niveli i arkëtimit të masave zhdëmtuese është 1,097,388 lekë kundrejt **32,839,607 lekë ose 3,34%.**

Ish-Kryetari Bashkisë dhe Strukturat përkatëse nuk ka marrë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm, **pasi nuk është kthyer përgjigje në afatin 20 ditor dhe nuk ka një plan veprimi bashkëlidhur, si dhe Urdhri i Brendshëm nr. 121, datë 9.11.2015 “Mbi zbatimin e detyrave të KLSH për Bashkinë Kavajë”, është i pjesshëm e selektiv, si edhe nuk është kërkuar zbatimi dhe raportimi i realizimit nga stafi.**

Gjithashtu nuk ka një raportim me shkrim pas afatit 6 muaj pra pas datës 01.03.2016, mosveprim në kundërshtim me të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, që ngarkon me përgjegjësi z. E.R, me detyrë ish-Kryetar Bashkie dhe zj. M.P, me Detyrë Drejtore Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse (Trajtuar hollësisht në faqet 7-67të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, Drejtoria Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Ekonomike të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara të KLSH-së, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **31,522,219 lekë, dhe të 16 masa organizative me vlerën 23,384,315 lekë veçanërisht masën organizative–zhdëmtuese nr. 1 a,b me vlerën 15,230,092 lekë të pa urdhëruar e përfshirë për zbatim ne urdhrin nr. 121, datë 9.11.2015 te ish-Kryetarit të Bashkisë.**

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kavajë nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Sistemi i kontrollit të brendshëm nuk funksionon si duhet. Nuk analizohet e përmirësohet ky sistem. Veprimtaria e përditshme e punës së Bashkisë Kavajë është mbështetur në rregulloren e brendshme të administratës të miratuar në vitin 2001, e cila nuk pasqyron në mënyrë të plotë detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve, nuk reflekton ndryshimet strukturore dhe ligjore që kanë ndodhur

për shkak të reformës territoriale. Nuk është hartuar rregullore e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat. Strategjia e menaxhimit të risqeve është e karakterit teorik. Objektivat janë jo konkrete, të pa matshme nuk krijojnë mundësinë e monitorimit dhe vlerësimit. Nuk janë hartuar plane konkrete vjetore dhe strategjike për zhvillimin e njësisë vendore (*Trajtuar më hollësisht faqet 67-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të marrë masa për implementimin e një sistemi të shëndosh rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke hartuar rregullore dhe procedura të qarta për të gjithë aktivitetin e përditshëm të institucionit. Ky sistem të monitorohet dhe përmirësohet në vazhdimësi. Të hartohet rregullorja e brendshme e institucionit. Nga secila drejtori dhe për aktivitetet kryesore të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit, dhe harta e proceseve të punës. Të hartohen plane konkrete, strategjike e vjetore për zhvillimin e njësisë vendore.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi.

3. Gjetje nga auditimi: Njësia e auditit të brendshëm nuk i ka dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi në auditimet e planifikuara dhe të realizuara nuk është bazuar në vlerësimin e riskut. Nuk janë kryer auditime në fushat me risk, si prokurimet publike, kontratat e dhënies me qira, administrimi i aseteve e tjera të institucionit, debitorët e taksave dhe tarifave vendore, etj. Funksionimi i saj formal ka bërë që gjetjet dhe rekomandimet janë vetëm të karakterit organizativ, jo të nivelit thelbësor. Për periudhën 2015-2016 niveli i gjetjeve me karakter dëm ekonomik është mjaft i ulët, në vlerën 71,400 lekë në sistemin e pagave të punonjësve. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik (*Trajtuar më hollësisht në faqet 67-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Njësia e auditit të brendshëm të marrë masa për rishikimin e planit vjetor dhe strategjik, duke planifikuar në to auditime në fusha me risk, si prokurimet publike, asetet e institucionit, rregullshmëria e veprimeve të kryera me bankë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike për arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Kavajë prej vitit 2005 i është dhënë donacion një fond dhuratë nga Presidenti A M, me destinacion përdorimi për ngritjen e Muzeut të Aktorit Aleksandër Mojsiu, por për përdorimin e këtij fondi mungon transparenca dhe materializimi, administrimi dhe inventarizimi i tij, veprime në kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*Trajtuar në faqen 68-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Njësia e auditit të brendshëm të auditojë ecurinë lidhur me administrimin dhe menaxhimin e fondit të dhënë dhuratë nga Presidenti Z. Mojsiu për Muzeun “Aleksandër Mojsiu”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë për vitet 2015 dhe 2016 nuk ka zbatuar procedurat e Përgatitjes së PB vitit 2015 dhe PBA e 2015-2017, dhe të PB vitit 2016, PBA e 2016-2018, pra nuk ka hartuar e paraqitur Buxhetet përkatës sipas Formularëve nr. 1 dhe nr. 2, dhe sipas programeve përkatës, nuk ka funksionuar Grupi për Strategji Buxhet dhe Integrim (GSBI), nuk janë ngritur Ekipe të Menaxhimit të Programit (EMP), ka munguar Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) lidhur me mos hartimin e Strategjisë Zhvillimit Ekonomik, mungojnë përcaktimi dhe bazimi në Objektivat, Misionit Vizionit dhe Plan veprimeve afatshkurta afatmesme, që kanë sjellë si pasojë mosmbështetjen në të PB dhe PBA 2015-2017 buxhete faktik jo funksional, mos zhvillim të qëndrueshëm me pasoja buxhete nën kapacitetet e

mundësitë lidhur me parashikimin e burimeve nga të ardhurat, duke mos vënë në efikasitet të plotë Asetet dhe resurset, si dhe lidhur me parashikimin e shpërndarjes së Burimeve financiare duke mos parashikuar burime financiare për 20 funksione kryesore, gjeneruese burimesh financiare; në kundërshtim me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, me udhëzimin nr. 7/1, datë 28.2.2014 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”,

Në Buxhetet faktik vjetor të paraqitur në fundviti në secilin prej viteve 2015-2016 nuk janë marrë në konsideratë treguesit për resurset si për parashikimin e të ardhurave ashtu dhe për parashikimin e shpenzimeve për plotësimin e funksioneve, që tregojnë që buxhetet, nga moszbatimi i procedurave ligjore si në hartimin, ashtu e në zbatimin, kanë qenë buxhete joreal, të pasaktë, me rezerva, buxhete jofunksional, aspak mbështetës për arritjen e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Kjo vërtetohet nga moszbatimi mos korrektimi e mospërfshirja në ndryshime, me pasoje parashikimi me rezervë i të ardhurave dhe nga moszbatimi i procedurës hartimit të PB, miratimit të buxhetit përfundimtar (*Trajtuar ne faqet 70-76 të Raportit Përfundimtar te Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore në Përgatitjen Hartimin të PB-ve dhe PBA-ve, të hartojë Buxhetet sipas Formularëve standardë, të ngrejë e funksionojnë strukturat përkatëse të hartimit duke u mbështetur në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) në Objektivat, Misionin, Vizionin dhe Plan veprimet përkatëse afatshkurta afatmesme me synim sigurimin e buxheteve funksional e real, parashikimin real të burimeve nga të ardhurat, vënien në efikasitet të plotë Aseteve dhe resurseve, si dhe parashikimin real të shpërndarjes së Burimeve financiare për siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe mbulim të plotë të funksioneve.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi.

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë në Buxhetet faktik vjetor të paraqitur në fundviti, pas ardhjes së transfertës, për secilin prej viteve 2015-2016 nuk ka parashikuar, llogaritur e përfshirë shpenzimet:

a.-Për vënien në zbatim të 2 planeve të Menaxhimit e Mbarështrimit të Pyjeve, si burim gjenerimi të ardhurash e punësimi në NJA Rurale, me afat 10 vjeçar, që kanë një kosto por dhe që vlerësohen aktuale pasi janë thuajse të pa zbatuar, gjë që GSBI duhej ti merrte në konsideratë ne programin për Buxhetimin për Pyjet, gjendje kjo ne kundërshtim me ligjin nr.9385 të ndryshuar “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar.

b.- Nuk janë parashikuar e përfshirë në një Strategji për vënien në efikasitet nën administrim të Planit të Menaxhimit të Aseteve dhe Resurseve, si kusht paraprak, shpenzimet në vlerën prej **154,644 mijë lekë** për Aplikime, përgatitje dokumentacioni dhe tarifa për regjistrim të rreth **6142 pasuri** pasurive të paluajtshme prona të Bashkisë, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, me ligjin nr. 9224, datë 24.5.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, me udhëzimin nr. 7/1, datë 28.2.2014 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”(Trajtuar ne faqet 70-76 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).

6.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa në hartimin e PB-ve dhe PBA-ve, pas shqyrtimit të përfshirë e marrë në konsideratë ne programin për Buxhetimin për Pyjet, 2 planeve të Menaxhimit e Mbarështrimit të Pyjeve, si burim gjenerimi të ardhurash e punësimi në NJA Rurale, me afat 10 vjeçar; si dhe për marrjen nën administrim dhe vënien në efikasitet sipas një Planit të Menaxhimit të Aseteve dhe Resurseve, parashikimin dhe përfshirjen e shpenzimeve në vlerën prej **154,644 mijë lekë** për Aplikime, përgatitje dokumentacioni dhe tarifa për regjistrim të rreth **6142 pasuri** pasurive të paluajtshme prona të Bashkisë si kusht paraprak,për përfshirjen e tyre në Kontabilitet.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi.

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë lidhur me zbatimin e Buxheteve faktik vjetor për vitet 2015 dhe 2016 ka rezultuar me:

a. Nivele të ulëta realizimi, përkatësisht: **Viti 2015** Plani i korrektuar është realizuar në nivelin **77,8 %**, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **734,282 mijë lekë** kundrejt planit **944,236 mijë lekë**, me diferencë mosrealizimi prej **-209,956 mijë lekë**. Ky mosrealizim krahas mangësive të tjera në hartim menaxhim është ndikuar kryesisht nga vonesa **prej 2muaj e miratimit, ndërsa Viti 2016** Plani i korrektuar është realizuar në nivelin **73,5 %**, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **950,782 mijë lekë** kundrejt planit **1,292,894 mijë lekë**, me diferencë mosrealizimi prej **-342,112 mijë lekë, ku peshën kryesore e zëne mosrealizimi i të ardhurave megjithëse të parashikuara me rezerva**. Ky mosrealizim krahas mangësive të tjera në hartim menaxhim është ndikuar kryesisht nga vonesa **prej 2muaj e miratimi si dhe nga mungesa e ndjekjes dhe analizave periodike mujore dhe 4 mujore sipas fazave të raportimit**.

b. Njëanshmëri në ndjekjen e zbatimin e treguesve të realizimit të buxhetit nga Grandi dhe prirje tendencë e nënvleftësim në përgatitjen, mobilizimin e zbatimin e pjesës së buxhetit vendor nga të ardhurat. Kështu referuar strukturës së burimit të ardhurave, **në vitin 2015** buxheti nga grandi është realizuar **78,4 % (616,216: 785,794)**, ndërsa nga të ardhurat është realizuar **74,5 % (118,066: 158,442)**, ndonëse të ardhurat e parashikuara janë tejjet me rezerva dhe jo reale sipas mundësive; ndërsa **në vitin 2016**, buxheti nga grandi është realizuar **82,8 % (659,414:795,934)**, ndërsa nga të ardhurat është realizuar **58,6% (291,368:496,960)**, ndonëse të ardhurat e parashikuara janë tejjet me rezerva dhe jo reale sipas mundësive; gjendje kjo në kundërshtim me; ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015", me Udhëzimin nr 2, datë 9.1.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", nr 3, datë 16.1.2015 "Për Procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit të vitit 2015", ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016" dhe me Udhëzimet "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", "Për Procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit të vitit 2016" pasqyruar në tabelat "Hartimi, miratimi dhe realizimi i objektivave të buxhetit viti 2015", "Hartimi, miratimi dhe realizimi i objektivave të buxhetit viti 2016" (*Trajtuar në faqet 70-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të vazhdueshme për zbatimin e plotë të realizimit të Buxheteve të Planifikuara vjetor, eliminimin e mosrealizimeve dhe të njëanshmërive në ndjekjen e zbatimin e treguesve të realizimit të buxhetit nga Grandi me prirje tendencë e nënvleftësim në përgatitjen, mobilizimin e zbatimin e pjesës së buxhetit vendor nga të ardhurat me synim arritjen e plotësisht të objektivave, për zhvillim të qëndrueshëm përmbushjen e funksioneve dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shpërblimeve u konstatua se Bashkia Kavajë ka kryer largime të padrejta nga puna, procedura për të cilat punonjësit e larguar pas ankimimit në gjykatë kanë fituar të drejtën e pagesës për vlerën totale **4,441,947 lekë**. Vendimmarrje të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhet, pasi për të njëjtin vend pune janë kryer pagesa të dubluara, për të cilat Bashkia Kavajë nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse ndaj personave përgjegjës, në kundërshtim me UMF nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011" pika 6.1 dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 62 dhe 102. (*Trajtuar në faqet 77-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktar të krijimit të detyrimit në vlerën **4,441,947 lekë**, për largime të padrejta nga puna, shumë e cila ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Për transferimin e pasurisë së njërive që shkrihen ish-Komunat, si dhe të Bordi Kullimit, të përthithura nga Njësia administrative Bashkia Kavajë në zbatim të reformës territoriale, është kryer punë e pamjaftueshme për dorëzimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si dhe të dokumentacionit ligjor me të dhënat e nevojshme për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara nëpërmjet inventarizimit të vlerave materiale inventar, si pasojë e mungesës së komisioneve të ngritura për këtë qëllim ka sjell mos administrim të vlerave në shumën e konsiderueshme **15,659,325 lekë**, veprime në mospërputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015(*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marr masa për të administruar nëpërmjet inventarizimit të vlerave materiale, inventar ekonomik dhe të pasurisë së ish-Komunave, apo të transferuara nga Bordi Kullimit të përthithura nga Njësia shpenzuese Bashkia Kavajë, me qëllim që gjendja në periudhën raportuese pasardhëse të jetë sa më e saktë.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Në njësinë administrative Bashkia Kavajë (*përfshirë njësitë administrative*), në lidhje me administrimin e pasurive të përthithura pas transferimit të pasurisë së njërive që u shkrinë (*ish/Komunat*) u konstatuan mangësi e shkelje në zbatimin e procesit të dorëzimit dhe inventarizimit fizik të vlerave materiale inventar ekonomik, si dhe të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme nga organizimi, kryerja, përfundimi dhe nxjerrja e rezultatit duke sjell diferencë me vlera të konsiderueshme, për pasojë pasqyra financiare nuk quhet se, pasqyron realitetin e pasurisë së institucionit, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*”, neni 7 “*Inventari i aktiveve e detyrimeve*”; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*” (*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marr masa për të administruar, nëpërmjet inventarizimit të plotë për të gjitha vlerat materiale inventar ekonomik dhe aktive të qëndrueshme, pasuri e administruar nga njësia shpenzuese Bashkia (*e riorganizuar*), me qëllim që pasqyra financiare të pasqyroj realitetin e pasurisë së institucionit.

Menjëherë.

11.Gjetje nga auditimi: Në njësinë administrative Bashkia Kavajë, në inventarin e pasurisë i kryer në periudhat raportuese objekt i auditimit 2015; 2016 është evidentuar e administruar në llogarinë (212) “*Ndërtime e konstruksione*” edhe shuma **11,281,862 lekë** me përshkrim “*themele për pallati kulturës*” gjendje e mbartur nga periudha raportuese paraardhëse, në objektin “*Pallati i Kulturës*”, ndërkohë objekti është transferuar në pronësi të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ) me funksion “*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë*”, ç’ka tregon se inventarizimi fizik i kryer në këto periudha është fiktiv, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*”, neni 7 “*Inventari i aktiveve e detyrimeve*”; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*” (*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marr masa për të transferuar në njësinë shpenzuese ZABGJ vlerën prej **11,281,862 lekë** e përshkruar në zërin “*themele për pallati kulturës*” të kryera për ndërtimin e objektit, me qëllim që kjo vlerë të administrohet në

vlerën e objektit, ndërsa të mos jetë e evidentuar dhe pasqyruar 2 herë në vlerën e këtij objekti.

Menjëherë.

12. Gjetje nga auditimi: Njësia administrative Bashkia Kavajë në procedurat e daljes jashtë përdorimi të vlerave materiale të miratuara me VKB, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për të nxjerr urdhrin e ngritjes së komisionit për verifikimin, vlerësimin e zbatimin e procedurës së asgjësimit e shkarkimin e tyre nga librat e llogarisë dhe kartelat inventar në periudhën raportuese 2015 për shumën **4,184,166 lekë** dhe periudhën raportuese 2016 për shumën **3,168,599 lekë**, në kushtet kur këto vlera materiale rezultojnë të shkarkuara nga gjendja kontabile dhe nuk administrohen në regjistër gjendje “*ekstra kontabile*”, apo mall në ruajtje ndërsa procesi i asgjësimit fizik nuk është kryer, krijohen premisa për riqarkullim përsëri të këtyre vlerave materiale në gjendjen inventar të periudhës raportuese pasardhëse, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*”, neni 7 “*Inventari i aktiveve e detyrimeve*”; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*” (*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marr masa me qëllim që të administrohen me komision të veçantë, procedura e verifikimit dhe vlerësimin të gjendjes fizike të vlerave inventar ekonomik e inventar imët të cilësuar (*jashtë përdorimi*), si dhe të zbatohen të plota procedurat e asgjësimit dhe shkarkimit nga librat e llogarisë dhe kartelat inventar.

Menjëherë.

13. Gjetje nga auditimi: Të gjitha dosjet e tenderave që u audituan për Bashkinë Kavajë, rezultuan se nuk janë inventarizuar, numerizuar dhe arshivuar. Edhe pse tenderat kanë përfunduar një apo dy vjet më parë dosjet ruhen ende në zyrën e njësisë së prokurimit. Mosinventarizimi nuk garanton se në dosje ndodhet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe mos arshvimi nuk garanton ruajtjen e dokumentacionit, veprim në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” për ruajtjen e dokumentacionit (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13. 1. Rekomandim: Nga njësia e prokurimit të numerizohen, inventarizohen dhe arshivohen të gjitha dosjet e prokurimeve publike dhe ky rregull të ndiqet për çdo dosje tenderi, pasi përfundon procedura e prokurimit publik.

Menjëherë.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tenderave të pastrimit për qytetin e Kavajës dhe Njësitë Administrative, u konstatuan mangësi në drejtim të planifikimit të gabuar të zërave të preventivit, për arsye të mungesës së normativave mbi të cilat Bashkia duhet të mbështetet për kryerjen e llogaritjeve të fondit limit, nevojës për makineri e fuqi punëtoare, apo planifikim i zërave të cilët nuk përfshihen ligjërisht të mbeturinat publike, me pasojë krijimin e efekteve negative në buxhet dhe nevojën e rishikimit të kontratave të lidhura. Këto veprime vijnë nga mungesa e hartimit të rregullores për largimin publik të mbeturinave, në kundërshtim me kërkesat e nenit 9 të ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”. (*Trajtuar hollësisht në faqet 162-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit procesverbalin nr. 25, datë 09.05.2017*).

14.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë në bashkëpunim me organet kompetente, sipas rregullores për shërbimin e pastrimit publik, të hartojë rregulloren e vet për këtë qëllim, ku të përcaktohen metodat dhe teknologjitë që do të përdoren për largimin publik të mbeturinave,

si dhe të gjitha normativat dhe specifikimet e nevojshme, të cilat do të jenë bazë për hartimin e analizës së kostos, preventivit dhe kontratave me sipërmarrësit në këtë fushë.

Menjëherë.

15.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njesisë Administrative Golem”, zhvilluar në vitin 2016, në kriteret e veçanta të DST është përcaktuar se “*Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi apo me qira një ambient me sipërfaqe rreth 1,000m², i cili do të shërbeje për parkimin e mjeteve jashtë orëve të shërbimit, depozitimit dhe riparimin e kontenierëve të dëmtuar, si për depozitimin e materialeve që i nevojiten për realizimin e plote të shërbimit të pastrimit. Vendndodhja e këtij ambienti duhet të jete brenda territorit të njesisë administrative objekt i kësaj kontrate ose brenda territorit të qytetit Kavajë*”. Ky kriter ka qemë element skualifikues për operatorët ekonomik por, edhe pse kontraktori “K” shpk, në dokumentet e tenderit ka paraqitur kontratë noteriale qiraje për sipërfaqen truall dhe ndërtesë 1345 m², nga auditimi u konstatua se mjetet e angazhuara në tender nuk parkohen në ambientin e deklaruar, por në qytetin e Tiranës, por nuk është zbatuar kjo kontratë në lidhje me mjetet që angazhohen në këtë tender, në kundërshtim me kriteret e vendosura në DST, veprim i cili cenon realizimin e plotë dhe me cilësi të shërbimit të pastrimit nga kontraktori (*Trajtuar hollësisht në faqet 162-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

15.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të menjëhershme për zbatimin nga operatori ekonomik “K” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit, të kriterit të DST për pasjen në dispozicion të ambientit me sipërfaqe rreth 1,000m², brenda territorit të njesisë administrative ose brenda territorit të qytetit Kavajë, i cili do të shërbej për parkimin e mjeteve jashtë orëve të shërbimit, depozitimin dhe riparimin e kontenierëve të dëmtuar, etj. Në rast të kundërt të kërkohet zgjidhja e kontratës me kontraktorin.

Menjëherë

16. Gjetje: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 4, paragrafi 4.

16.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në njësinë administrative Bashkia Kavajë (*përfshirë njësitë administrative*) nga Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore është kryer punë e pamjaftueshme në lidhje programimin dhe përlllogaritjen e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të tarifa e taksa vendore të miratuara me VKB në paketën fiskale, si pasojë e mungesës dhe administrimit të regjistrave për të evidentuar dhe saktësuar numrin e subjekteve (*familjar, biznese, mjete transporti e pasuri e paluajtshme “ndërtesa e toka”*) mbi të cilat nga administrimi i saktë i të dhënave edhe përlllogaritja nuk do të sillte të ardhura të munguara për buxhetin e njesisë shpenzuese në vlerën **23,455,500 lekë** (*Trajtuar hollësisht në faqet 247-265 Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

17. 1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, të marr masa për të mbajtur dhe administruar regjistrat përkatës, me të dhëna të nevojshme e të domosdoshme për të evidentuar numrin e saktë të familjeve, numrin e banesave, ndërtesave, tokës, numri biznesit, numri mjeteve të transportit në juridiksion të njesisë administrative me qëllim që përlllogaritja e detyrimeve që lindin nga aplikimi i nivelit të tarifave e taksave vendore të jetë sa më i saktë dhe më afër realitetit.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi: Si pasojë e mos administrimit dhe mos evidentimit të nivelit të zonës së riskut për borxhin e krijuar veçanërisht të periudhës deri në 1-vit u konstatua se, Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore me evidencën statistikore ka paraqitur shtesë debitorë në vlerën **63,171,589 lekë**, ndërsa me analizën për moshën e krijimit të borxhit ka pasqyruar vlerë **82,623,314 lekë** me diferencë më tepër e pa argumentuar dhe e pa administruar në shumën prej **19,451,725 lekë**. (*Trajtuar hollësisht në faqet 247-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore dhe (Sektori i Menaxhimi të Borxhit), të marr masa të plota për mbledhjen **82,623,314 lekë taksa si dhe të marrin masa për të sistemuar e argumentuar** diferencën prej **19,451,725 lekë** vlerën e borxhit i lindur me të dhëna të pasakta, nëpërmjet analizës së plotë të detyrimeve të pa paguara nga subjektet, me qëllim që vlera e detyrimeve të jetë sa më afër realitetit.

Menjëherë.

19.Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e nivelit të tarifave e taksave të miratuara pas përlllogaritjes së detyrimit u konstatua se, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për detyrimet e lindura për pagesë nga subjektet (*familjar apo biznesi*), nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore në njoftimin e detyrimit nuk është evidentuar me analizë cdo detyrim i lindur, njëkohësisht shpërndarja e njoftim detyrimit është dërguar vetëm në subjekte biznesi, ndërsa nuk është dërguar për në subjektet familjar në juridiksion të njësisë administrative me detyrimet e lindura, njëkohësisht njoftimi për detyrimin nuk është drejtuar edhe në zyrën financës me qëllim që çdo detyrim të kontabilizohet. (*Trajtuar hollësisht në faqet 247-265 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkia Kavajë të nxjerr urdhër që Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, për detyrimet e lindura për pagesës të pasqyruara në “*Njoftim detyrimi*”, një kopje e tij detyrimisht të drejtohet në zyrën financës me qëllim që detyrimi të kontabilizohet dhe shuma e detyrimit nëpërmjet kontabilizimit të administrohet në kontabilitet me analizë dhe me përfundimin e afatit të pagesës, për çdo detyrim të pa likuiduar i administruar nga Sektori i Menaxhimit të Borxhit të përlllogariten kamat vonesat përkatës dhe të aplikohen penalitete, veprim i pa realizuar deri në këtë moment.

Menjëherë.

20.Gjetje: Bashkia Kavajë lidhur me Hartimin e Planit të Përgjithshëm të Vendor (PPV) ka në vazhdim të procedurës miratimit e tre dokumenteve të PPV nga Kryetari i Bashkisë nga Këshilli Bashkiak dhe dërgimi e marrjen e miratimit në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT). *Pra hartimi i PPV ndodhet në vazhdim të procedurave përfundimtare të miratimit. Nga një vështrim i shkurtër i strukturës së projektit të PPV përbërë nga 3 komponentë konstatojmë se nuk reflektohen qartësisht elementet si: a. analiza e konsoliduar e cila përfshinë pikat e forta dhe mundësitë, pikat e dobëta dhe kërcënimet; b. Matrica e Qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të planit; c. Matrica e zbatimit të planit; d. Matrica e prioritarizimit të projekteve; dhe e. Fishat e projekteve) të gjitha këto shoqëruar me shpërndarjen e buxheteve të nevojshëm apo **burimet e financimit të mbuluar nga buxheti i Bashkisë, dhe buxheti Qendror, me synim që ky të jetë sa më funksional i aplikueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm nga personeli zbatues gjatë shtrirjes në kohën prej 25 vjetësh te parashikuar por edhe lehtësisht i monitorueshëm, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ligjin nr.10296, datë 10.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”** (*Trajtuar hollësisht ne faqet 265-268 të Raportit Përfundimtar te Auditimit*).*

20.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, Kryetari dhe Këshilli Bashkiak të marrin masa, të vazhdojnë procedurat deri në miratim dhe me grup të veçantë të shqyrtojnë plotësinë, saktësinë dhe funksionalitetin e **strukturës së projektit të PPV përbërë nga 3 komponentë**

*ku të reflektohen qartësisht elementet si: a. analiza e konsoliduar e cila përfshinë pikat e forta dhe mundësitë, pikat e dobëta dhe kërcënimet; b. Matrica e Qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të planit; c. Matrica e zbatimit të planit; d. Matrica e prioritarizimit të projekteve; dhe e. Fishat e projekteve) të gjitha këto shoqëruara me shpërndarjen e buxheteve të nevojshëm apo **burimet e financimit të mbuluar nga buxheti i Bashkisë dhe buxheti Qendror, me synim që Projekti PPV të jetë sa më funksional i aplikueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm nga personeli zbatues gjatë shtrirjes në kohën prej 25 vjetësh te parashikuar por edhe lehtësisht i monitorueshëm.***

Menjëherë

21.Gjetje nga auditimi: Gjendja e inventarizimit të 56 dosjeve, (43 dosje leje zhvillimi dhe 13 dosje leje përdorimi) është e paraqitur vetëm me listë emërtimi dokumentesh pa numër fletësh për secilin dokument dhe pa numër fletësh progresiv te dokumentacionit përbërës të dosjes, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.01.1993 “Për Arkivat” pasqyruar në tabelat emërtuar: **”Tabela e lejeve te ndërtimit Bashkia Kavajë viti 2015 Tabela 1.1 “ dhe “Tabela e lejeve te ndërtimit viti 2016 Bashkia Kavajë Tabela nr. 1.2” (Trajtuar hollësisht ne faqet 265-268 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).**

21.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit të marrë masa të inventarizojë 56 dosjeve, (43 dosje leje zhvillimi dhe 13 dosje leje përdorimi) me numër fletësh progresiv për çdo dosje dhe çdo emërtimi dokumentesh përbërës të dosjeve, konformë ligjit të inventarizimit dhe administrimit të dokumenteve arkivor, pasqyruar në tabelat emërtuar:”Tabela e lejeve te ndërtimit Bashkia Kavajë viti 2015 Tabela 1.1 “ dhe “Tabela e lejeve te ndërtimit viti 2016 Bashkia Kavajë Tabela nr. 1.2, dhe tabelat “Lejet e Përdorimit te Miratuara dhe Mungesa e Aplikimit të Gjobave për Vonesat Viti 2015-2016 Tabela nr.2.1, dhe 2.2”, bashkëlidhur

Menjëherë

22.Gjetje: Bashkia Kavajë (Autoriteti Zhvillimit Territorit),Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit **për vitin 2015-2016 në dhënien e 5 lejeve të ndërtimit për 5 objekte në troje publike me financim publik** nuk ka llogaritur vlerësuar e përfshirë në kontabilitet për secilin vlerë të objektit përkatës **vlerën prej 8,083,537 lekë** e tarifës së ndikimit në infrastrukturë përkatësisht **3 ne vitin 2015** me vlerën **2,627, 025 lekë** përkatësisht ndarë vlera **1,000,000 lekë** për lejen e ndërtimit të objektit “Rruga e daljes (zona industriale “,rikualifikim i plote (trotuar, asfalt) faza II **vlera 1,420,101 lekë**, për lejen ndërtimit objektit “Rikonstruksion i rrugës fragment i shëtitores nr.1 (nga teqja–rruga dalëse)” si dhe vlera **206,924 lekë** për lejen e ndërtimit të objektit “Ndërtim Kopshti ne lagjen nr.2 tek ish-rezervat e shtetit Kavajë”; ndërsa 2 në vitin 2016 me vlerën **5,456,512 lekë, përkatësisht vlera 4,460,065 lekë për lejen e ndërtimit të objektit “Rehabilitim i Përroit te Leshniqes“ dhe vlera prej 996,506 lekë për lejen e ndërtimit të objektit “Ndërtimi i Shkollës”Rilindja”**, vlera këto që do të përfshihen në vlerën e kostos së marrjes së objektit në kontabilitet, mosveprim që vjen në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me ligjin nr.9228, dtë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”,pasqyruara në tabelat cituar më sipër (Trajtuar hollësisht ne faqet 265-268 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).

22.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike të marrin masa të llogarisin e sistemojnë, regjistrojnë në Kontabilitet për secilin prej 5 objekteve **vlerën prej 8,083,537 lekë** e tarifës së ndikimit në infrastrukturë përkatësisht **3 ne vitin 2015** me vlerën **2,627, 025 lekë** përkatësisht ndarë vlera **1,000,000 lekë** për lejen e ndërtimit të objektit “Rruga e daljes (zona industriale “,rikualifikim i plote (trotuar,asfalt) faza II **vlera prej 1,420,101 lekë** për lejen e ndërtimit të objektit “Rikonstruksion i rrugës fragment i shëtitores nr.1 (nga teqja–rruga dalëse)” si dhe vlera **206,924 lekë** për lejen e ndërtimit të objektit “Ndërtim Kopshti ne lagjen nr.2 tek ish-

rezervat e shtetit Kavaje”; ndërsa 2 në vitin 2016 me vlerën **5,456,512 lekë, përkatësisht vlera 4,460,065 lekë për lejen e ndërtimit të objektit “Rehabilitim i Përroit te Leshniqes“** dhe **vlera prej 996,506 lekë për lejen e ndërtimit të objektit “Ndërtimi i Shkollës”Rilindja”**, vlera këto që do të përfshihen në vlerën e kostos së marrjes së objektit në kontabilitet bashkë me koston sipas situacioneve përkatëse, të pasqyruara analitikisht në tabelat cituar më sipër.

Menjëherë

23.Gjetje: Bashkia Kavaje ka marrë në dorëzim **2 plane Mbarështimi përkatësisht** Plani Menaxhimit të pyjeve Komuna Synej me afat 10 vjeçar shtrirje deri v.2017 dhe Plani Mbarështimi të pyjeve dhe kullotave Komuna Helmas me afat 10 vjeçar shtrirje deri v.2017, me vlera të dokumentacionit dhe njohurive Know-how por në marrjen në dorëzim nga pala dorëzuese nuk jepen të dhëna dokumente për ecurinë e zbatimit të tyre, që do të ndihmonte nismën për vlerësimin e vazhdimin e zbatimit të tyre në periudhën e mëvonshme nga Bashkia Kavajë, me synim vënien nën administrim, menaxhim të fondit pyjor prej mbi **1296 ha** (prej saj 95 ha inproduktive), gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin e komunitetit të zonave rurale, vendosjen dhe inicimin e bashkëpunimit me shoqatat e përdorimit të Pyjeve kullotave e operatoreve të tjerë në këtë fushë por edhe përdorimin e burimeve të ardhurave nga pyjet sipas destinacionit ligjor, gjendje kjo në kundërshtim me pikën 6 të shkresës nr 7531, datë 28.12.2015 “Mbi marrjen e masave për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave”, të Ministrit të Mjedisit për “shqyrtimin e planeve të Mbarështimit për fondin Pyjor dhe Kullosor”.

Gjithashtu mungojnë plani operacional vjetor për vitin 2016 për aktivitetet vjetore në pyje kullota bazuar në të dhënat e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve për vitin referues në planet e mbarështimit dhe mungojnë përfshirja në planin vjetor buxhetor “Programi i pyjeve dhe kullotave”, pra në përfshirje dhe apo ndryshime në Buxhetin korrent 2016 të Bashkisë, në kundërshtim me pikën 7 dhe 17 të urdhrin të ministrit të Mjedisit nr. 7531, datë 28.12.2015 (*Trajtuar në faqet 272-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të rishqyrtojë, vlerësojë dhe vërë në efikasitet zbatimin e **2 plane Mbarështimi përkatësisht:** “Plani Menaxhimit të pyjeve Komuna Synej me afat 10 vjeçar shtrirje deri v.2017 dhe ‘Plani Mbarështimi të pyjeve dhe kullotave Komuna Helmas me afat 10 vjeçar shtrirje deri v.2017’”, si dhe të hartojë planin operacional vjetor për aktivitetet vjetore në pyje kullota bazuar në të dhënat e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve me synim vënien nën administrim, menaxhim të fondit pyjor prej mbi **1296 ha** (prej saj 95 ha inproduktive), gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin e komunitetit të zonave rurale, vendosjen dhe inicimin e bashkëpunimit me shoqatat e përdorimit të Pyjeve kullotave e operatoreve të tjerë në këtë fushë por edhe përdorimin e burimeve të ardhurave nga pyjet sipas destinacionit ligjor.

Menjëherë

24.Gjetje: **Nuk janë përfshirë në listën e pronave të Bashkisë** dhe nuk janë dorëzuar fondi Pyjor në sipërfaqen **dhe pasuritë prej 100,15-90,56 ha** që i përket Ekonomisë pyjore “Malësia e Kavajës”, pra fondi pyjor në zonën bregdetare të Shkëmbit Kavajas, Golem ndodhur në juridiksion të ish-Komuna Golem, Bashkia Kavajë, trajtuar si më poshtë:

Në fondin pyjor ngastrat dhe n/ngastrat brenda sipërfaqes prej 81,55 ha të Ekonomisë Pyjore “Malësia e Kavajës“, ndodhur në zona pyjore “Golem“, janë zënë dhe ushtrojnë veprimtari 70 objekte me sipërfaqen 27,0648 m² (27,06 ha) nga 49 hotele me sipërfaqe trualli 11,8906 m² (11,9 ha), 17 kompleksë turistike me 8,2482 m² ose (8,2 ha) dhe 4 fshatra turistik me 69,260 m² ose (6.9260 ha) përcaktuar në tabelën emërtuar “Formulari 1.Lista përmbledhëse e ngastrave fond pyjor që i është ndryshuar destinacioni për shkak të ushtrimit të veprimtarive të miratuara në Ekonominë Pyjore “Malësia e Kavajës“, zona pyjore Golem“. Gjithashtu 19 subjekte të tjera për sipërfaqen prej 328.125 m² ose (32.8 ha) kanë marrëveshje me ministrinë e Turizmit sipas tabelës emërtuar “Lista e Subjekteve që kanë marrëveshje qiraje me Ministrinë e Territorit dhe Turizmit në Troje me Pronësi Shtetërore”, ndërsa edhe Bashkia

Kavajë ka marrë nga Ministria e Mjedisit dhe ish-DSHP, DRISHMP 13 kontrata qiradhënie sipërfaqe pyjore 14,9042 m² (14,9 ha) sipërfaqe e cila nuk i është transferuar dhe nuk përfshihet në listën e pronësisë VKM nr. 433, datë 08.6.2.2016, përcaktuar në tabelën emërtuar “Formulari 1.Lista përmbledhëse e ngastrave fond pyjor qe i është ndryshuar destinacioni per shkak te ushtrimit te veprimtarive te miratuara ne Ekonominë Pyjore “Malësia e Kavajës“, zona pyjore Golem“(Trajtuar në faqet 272-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë në Bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban, Turizmit dhe Ministrinë e Çështjeve Vendore të bëjnë identifikimin saktësimin dhe ndjekin procedurat ligjore për kalimin në kategori të fondit pyjor në truall pjesën nga sipërfaqja e fondit pyjor prej 81,55 ha të Ekonominë Pyjore “Malësia e Kavajës“, ndodhur në zona pyjore “Golem“, mbi të cilën janë dhënë leje dhe ushtrojnë veprimtari 70 objekte me sipërfaqen 27,0648 m² (27,06ha) nga 49 hotele me sipërfaqe trualli 11,8906 m² (11,9 ha), 17 komplekse turistike me 8,2482 m² ose (8,3 ha) dhe 4 fshatra turistik me 69,260 m² ose (6.9260 ha) përcaktuar në tabelën emërtuar “Formulari 1.Lista përmbledhëse e ngastrave fond pyjor qe i është ndryshuar destinacioni për shkak te ushtrimit te veprimtarive te miratuara ne Ekonominë Pyjore “Malësia e Kavajës“, zona pyjore Golem“. Gjithashtu 19 subjekte të tjera për sipërfaqen prej 328.125 m² ose (32.8 ha) kane marrëveshje me ministrinë e Turizmit sipas tabelës emertuar “Lista e Subjekteve qe kane marrëveshje qiraje me Ministrinë e Territorit dhe Turizmit ne Troje me Pronësi Shtetërore”, ndërsa edhe Bashkia Kavaje ka marrë nga Ministria e Mjedisit dhe ish-DSHP, DRISHMP 13 kontrata qiradhënie sipërfaqe pyjore 14,9042 m² (14,9 ha) sipërfaqe nuk i është transferuar dhe nuk përfshihet në listën e pronësisë VKM nr. 433, datë 08.6.2.2016, përcaktuar në tabelën emërtuar “Formulari 1.Lista përmbledhëse e ngastrave fond pyjor qe i është ndryshuar destinacioni për shkak te ushtrimit te veprimtarive te miratuara ne Ekonominë Pyjore “Malësia e Kavajës“, zona pyjore Golem“.

Menjëherë

25.Gjetje: Marrja në dorëzim e 13 kontratave të Qiradhënies të fondit dhe sipërfaqeve pyjore për qëllime në Golem Shkëmbi Kavajës; ka mangësi në dokumentacion përbërës të kontratave dhe mungojnë të dhënat e monitorimit sidomos pjesa e likuidimit të detyrimeve, si më poshtë:

2.a.1.Dokumentacioni përbërës i kontratave ka mungesa si: janë pa hartat përkatëse, të pa noterizuara të pa përditësuara në përputhje me ndryshimet e legjislacionit, nuk ka të identifikuar dorëzuar drurët pyjore etj: nuk ka të dhëna shkëmbim informacioni me ZVRPP Kavajë për regjistrimin e kontratave të përdorimit me *afatet 10-25 vjet si* dhe pasuritë pyjore objekt kontratash nuk janë të regjistruara në ZVRPP, ndërsa janë leshuar me qira afatgjatë ne kundërshtim me KC nenet 801-805, ligjin nr.33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për Përcaktimin e taifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, pika 1 “Tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik“, (të cilat nuk kanë ndryshuar me ndryshimet ne VKM nr.1064, datë 22.12.2010). Trajtuar në faqet 272-276 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).

25.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të rishqyrtojë, përditësojë e përshkruaje dokumentacionin përbërës të kontratave të eliminojë mangësitë duke pajisur me hartat përkatëse, ti noterizojë në përputhje me ndryshimet e legjislacionit, të identifikojë e dorëzojë drurët pyjore etj, dhe të shkëmbejë informacionin me ZVRPP Kavajë për regjistrimin e kontratave të përdorimit me *afatet 10-25 vjet si* dhe pasuritë pyjore objekt kontratash sipas KC nenet 801-805, ligjit nr.33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për Përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, pika 1 “Tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik“, (të cilat nuk kanë ndryshuar e përshtatur me ndryshimet ne VKM nr.1064, datë 22.12.2010)

Menjëherë

26.Gjetje: Bashkia Kavajë për fondin kullosor prej **541,8 ha ndarë:** 525.8 ha Helmas, 8,5 ha Golem dhe 7,5 ha Luz i Vogël **por edhe nga Ish-Komunat aktualisht Njësitë Administrative Helmas dhe Golem për vitin 2015 dhe 2016** nuk ka hartuar e nuk ka zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në kullota livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve; në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim. Për pasojë nuk ka gjetur zbatim pika 6 e VKM nr. 396, datë 21.6.2006, ku shprehet se: “... Jo më pak se 70% e fondit të krijuar sipas shkronjës “e” të pikës 5 të këtij vendimi përdoret për përmirësimin e pyllit Komunal” dhe me pikën 3 shkronja “e” ku shprehet se: “... Të realizojë menaxhim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të pyjeve, duke kryer investimet e parashikuara në Planin e Menaxhimit, me financimet e veta a donacionet...”

- Mungon e nuk është bëra mbajtja, evidentimi, administrimi, bilancimi i fondit kullosor, mosveprim ky në kundërshtim ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, neni 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullosor”, neni 14, “Planin e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”.

Nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën Dhjetor 2013-Qershor 2016 të sipërfaqes prej 541,8 ha kullotë, janë krijuar të ardhura të munguara dhe dëmi ekonomik në vlerën prej **650,160 lekë**, si dhe nuk është bërë ndarja e destinimi 70% e vlerës prej 455,112 lekësh, për tu përdorur për përmirësimin e pyjeve kullotave bashkisë, pra për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për vënien në efikasitet të aseteve pyjorë dhe për mbarështimin (*Trajtuar në faqet 272-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të hartojë dhe zbatojë planin e menaxhimit e mbarështimit në kullota livadhe dhe plan veprimet vjetore të **fondit kullosor prej 541,8 ha ndarë:** 525.8 ha Helmas, 8,5 ha Golem dhe 7,5 ha Luz i Vogël, **të bëjë veçimin dhe destinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve 70% e fondit të krijuar sipas shkronjës “e” të pikës 5 të këtij vendimi përdoret për përmirësimin e pyllit Komunal**” dhe me pikën 3 shkronja “e” si dhe të realizojë menaxhim të qëndrueshëm të fondit kullosor; si dhe **të përfshijë ato në PB dhe PBA përkatëse.**

Menjëherë dhe në vazhdimësi

27.Gjetje: Bashkia Kavajë nuk ka një database inventar të menaxhimit dhe monitorimit kontratave të Qeradhënies, Përdorimit apo marrëveshjeve të tjera të lidhura me administrimin e pasurive Aseteve Resurseve të Bashkisë, si bazë që do të shërbente për vendosjen e mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB), rritjen e transparencës për publikun dhe për të treguar kurdoherë si dhe sa shfrytëzon këto pasuri e resurse, efektivitetin e vënies në efikasitet, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”(Trajtuar hollësisht në faqet 269-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të hartojë database inventar të menaxhimit dhe monitorimit kontratave të Qeradhënies, Përdorimit apo marrëveshjeve të tjera të lidhura me administrimin e pasurive Aseteve Resurseve të Bashkisë, si dokument bazë për vendosjen e mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

28.Gjetje: Nga Bashkia Kavajë me urdhrin nr.93, datë 9.10.15 është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e tarifës së qirasë për dy objektet e mësipërme përkatësisht: Ndërtesat ish-Fabrika Letrës, e iah- Depo Grumbullimi dhe mbi bazën e materialit të vlerësimit të gjendjes fizike të objekteve, me VKB nr.29, datë 31.12.2015 është vendosur tarifa për 20 lekë/m²/vit.

Kjo tarifë e vendosur dhe procedura e ndjekur për caktimin e nivelit të saj, pra në shmangie të VKM nr.54, datë 5.2.2014, megjithëse është një hap për miradministrim, por nuk mbështetet me asnjë akt nënligjor, pasi për të mos rënë ndesh me VKM 54, dhe meqenëse kjo VKM nuk mban parasysh amortizimin dhe gjendjen e ndërtesave objekt qiraje për strehim, por edhe VKM nr.926, datë 29.12.2014 “Për Kriteret e Vlerësimit të Pronës Shtetërore, që Privatizohet apo Transformohet, dhe Procedurën e Shitjes”, nuk përmban vlerësimin për qiradhënie, **atëherë në këto kushte Bashkia Kavajë do të duhej të kërkonte përmirësim nënligjor pra të VKM nr.54 datë 5.2.2014 për të rregulluar me akt nënligjor problemin e qiradhënies së objekteve të amortizuara që jepen për banesë dhe për më tepër për shtresa sociale me të ardhura të pakta** dhe që kërkojnë mbështetjen e Njesisë Vendore (Trajtuar hollësisht në faqet 276-285 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të ndërmarrë nismën, ndjek procedurat për përmirësim nënligjor pra të VKM nr.54 datë 5.2.2014 për të rregulluar me akt nënligjor problemin e qiradhënies së objekteve përkatësisht: Ndërtesat ish- Fabrika Letrës, e ish-Depo Grumbullimi, të amortizuara që jepen për banesë për shtresa sociale me të ardhura të pakta dhe që kërkojnë mbështetjen e Njesisë Vendore.

Menjëherë

29.Gjetje: Bashkia Kavajë ka dhënë për përdorim të përkohshëm me afat 20 vjeçar për ADISA; 494 m² nga sipërfaqja totale e katit I-rë dhe 2 zyra të tjera që ndodhen në Pallatin e Kulturës, sipas plan vendosjes dhe planimetrive, pa përcaktuar sipërfaqen dhe vend ndodhjen e 2 zyrave, sipas nenit 1, të Kontratës Huapërdorjes, pa nr, datë 01.11.2016 prot nr.2623/2, datë 1.11.2016 me afat 20 vjeçar dhe Marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavaje dhe Ministrisë Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), mungon Genplani dhe planimetria dhe mungon bilanci i sipërfaqes së Katit Pare, por dhe mungon regjistrimi dhe aplikimi në ZVRPP Kavajë i Kontratës Përdorimit, si dhe mungon regjistrimi i Pallatit të Kulturës sipas ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe sipas nenit 801-805 të Kodit Civil

Lidhur me pakësimin e sipërfaqe nga 200 m² në 130 m² për kontraktorin Bar kafe Art, mungon bilanci i sipërfaqes Kati I-rë (Trajtuar hollësisht në faqet 276-285 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të bëjë bilancin e sipërfaqes Katit I-rë dhe regjistrimin e kontratë-marrëveshjes përdorim të përkohshëm me afat 20 vjeçar për ADISA; 494 m² nga sipërfaqja totale e katit I-rë dhe 2 zyra të tjera që ndodhen në Pallatin e Kulturës, dhe gjithashtu të bëjë regjistrimin e pasurisë së objektit Pallat kulture duke përgatitur e dorëzuar dokumentacionin përkatës .

29.2. Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa lidhur me përshtatjen e VKB ne vendosjen e tarifave në përputhje me VKM, argumentimin e tyre, plotësimin e saktë të dokumentacionit të kontratave (kërkesa, kontrata, sipërfaqe salle apo holli, sipërfaqe fushe me përcaktim të saktë të orëve ditëve të përdorimit të ambienteve) dhe të marrë masa lidhur me zbatimin e procedurave në dhënien me qira orare apo ditore të sipërfaqeve të ambienteve Kinema “A.Mojsiu” dhe fusha sporti, me synim rritjen e transparencës dhe të ardhurave nga procesi i qiradhënies së ambienteve kulturore e sportive.

Menjëherë

30. Gjetje nga auditimi: Në bilancin e rërës vitit 2016 nuk është saktësuar e përfshirë sipërfaqja e rërës dhe statusi juridik, i përdorimit që i përket zonës plazhi Gjeneralit, NJA Synej përfshirja e të cilës do ta bënte bilancin më të plotë.

2.Mungon një VKB për vendosjen njohjen e shpalljen e plazheve publike, administrimin dhe menaxhimin e tyre, vendosjen e administratorëve dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, mirëmbajtjen e rregullit dhe pastërtisë, kontrollin respektimin gjatë sezonit me

synim vënien nën administrim dhe me efektivitet të vlerës prej **14,784,000 lekë**, të vënë në dispozicion të komunitetit në zbatim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“, UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe VKM nr.369, datë 18.5.2016 “Për Miratimin e Rregullores”Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”,

3. Bashkia duhet të bëjë identifikimin e subjekteve hoteleve resorteve të cilët sipas përkatësisë me front nga deti të pajisen me sipërfaqen përkatëse të rërës, me synim , shmangien e evazionit dhe të përdorimit pa marrëdhënie të sipërfaqeve të rërës nga subjekte dhe pa kontratë. *(Trajtuar hollësisht ne faqet 289-291 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1.Rekomandim: Bashkia Kavaje të marrë masa për të saktësuar e përfshirë sipërfaqja e rërës dhe statusi juridik, i përdorimit që i përket zonës plazhi Gjeneralit, të nxjerrë një VKB për vendosjen njohjen e shpalljen e plazheve publike, administrimin dhe menaxhimin e tyre, vendosjen e administratorëve, vendosjen e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, mirëmbajtjen e rregullit dhe pastërtisë kontrollin respektimin gjatë sezonit me synim vënien nën administrim dhe me efektivitet të vlerës prej **14,784,000 lekë**, të vënë në dispozicion të komunitetit si dhe të bëjë database dhe identifikimin e subjekteve hoteleve resorteve të cilët sipas përkatësisë me front nga deti të pajisen me sipërfaqen përkatëse të rërës, me synim shmangien e evazionit dhe të përdorimit pa marrëdhënie të sipërfaqeve të rërës nga subjekte dhe pa kontratë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

31. Gjetje nga auditimi: Të katër Kontratat e tokës bujqësore dhenë me qira nga ish-komuna Synej në sipërfaqen prej 7,38 ha me afat 99 vjet janë të pa noterizuara dhe të paregjistruara në ZVRPP, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, në përmbajtjen e kontratave mungojnë sanksionet dhe kamatëvonesat për mos likuidime apo likuidime të vonuara tej afatit, në kundërshtim me bazën ligjore të mësipërme me Kodin Civil “Kontrata e Qiradhënies Pasuri e Paluajtshme “Tokë bujqësore”, në kundërshtim me ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”(Trajtuar hollësisht në faqet 282-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

31.1.Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Synej të marrë masa të rishkruajë e plotësojë në formatin e duhur ligjor si dhe të noterizojë dhe të regjistrojë në ZVRPP katër Kontratat e tokës bujqësore dhenë me qira nga ish-komuna Synej në sipërfaqen prej 7,38 ha me afat 99 vjet.

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Synej ka munguar administrimi menaxhimi dhe vënia në efikasitet të aseteve të llojit vepra ujore, sidomos e rezervuarit H me sipërfaqe **240,000 m²** së bashku me skemat ujitëse i cili nuk është përfshirë në inventarin kontabël të ish- Komunës dhe të Bashkisë, në kundërshtim me ligjin dhe për vitin 2011 dhe 2012 nuk është kryer inventarizimi fizik i rezervuarit dhe aksesorëve përkatës të tyre, **me aksesorët përkatës si sistemeve ujitëse stacione e troje të tyre, monitorimin e funksionit ujitës, për periudhën 2013,2014, dhe deri 30.7.2015 dhe deri në v.2016** *(Trajtuar hollësisht ne faqet 291-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Synej të marrë, masa e të verë nën administrimin, menaxhojë me efikasitet, sipas destinacionit përkatës për ujitje, asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesorët përkatës, sidomos të rezervuarit “H” me sipërfaqe **240,000 m²** së bashku me skemat ujitëse i cili ta përfshijë në inventarin kontabël të Bashkisë.

Menjëherë

33. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Synej ka lidhur kontratën pa nr, datë 29.04.2008 me subjektin X, shpk Tiranë me objekt dhënie me qira Pjesë të Fondit Pyjor Komunal

Ekonomia Pyjore Synej Bardhore parcela nr.1-35 me kufijtë V “Kufiri natyror”, L: “Fshati Bardhor”, J. “Përroi Domenit”, P:”Deti Adriatik”.

Kjo kontratë mungon në origjinal e depozituar në arkiv, është e paqartë dhe pasaktë në përmbajtje në tregues dhe mungojnë anekset përkatëse bashkëlidhur dhe konkretisht: **a.**Në nenin 2.1 shprehet: “Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit sipërfaqen prej 2 ha e cila është pjesë e fondit pyjor komunal parcela nr.1-35..... “, por nuk përcakton saktë sipërfaqen pyjore në ha për më tepër referuar kufijve natyror me kufijtë V “Kufiri natyror”, L: “Fshati Bardhor”, J. “Përroi Domenit”, P:”Deti Adriatik”, çka do të thotë që sipërfaqja prej 2 ha nuk është e saktë, Referuar kufijëve të dhënë dhe sikundër shprehur, mbështetur në hartën pyjore të këtyre kufijeve rezulton se sipërfaqja në këta kufij është 323,6 ha, dhe jo për 130 ha sa paguhet.

b. në pikën 2.2 shprehet:” Qiradhënësi i jep Qiramarrësit edhe sipërfaqen prej 40,000 m², që do shërbejë për hapjen e rrugës së kalimit për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim me rrjetin rrugor ekzistuese (pa përcaktuar se ç’lloj rrjeti rrugor, i shtruar apo rrugë pyjore), çka tregon se një sipërfaqe rrjeti rrugor prej 4 ha nuk mund të shtrihet në sipërfaqen prej 2 ha si përcaktohet në pikën 2.1 argument që tregon se nuk është përcaktuar saktë dhe drejtë sipërfaqja pyjore e dhënë me qira.

c. Sipas pikës 2.4 ku shprehet:” Vendndodhja e parkut Eolik të ndërtuar nga Qiramarrësi dhe rruga tregohen në hartën Bashkëngjitur”,hartë ecila mungon dhe nuk i bashkëlidhet kontratës së paraqitur për auditim nga NJA Synej.

d. Në neni 5 Vlera e qirasë vjetore e vendosur prej 420,000 lekë nga e cila pika 5.1 për 260,000 lekë për parkun eolik, pika 5.2 për 160,000 lekë për 40,000 m² rrugë, siç shprehet sipas VKM nr.391, datë 21.0.2006, nuk është argumentuar dhe sipërfaqja sepse mungon harta që sipas tarifave të vkm 391. Mbështetur në lidhjen 2 pika 3e tarifave sipas VKM 391 konstatojmë:

Sipërfaqja e kontratës do të ishte: 30 ha (260,000 lekë/vit:2,000 lek/ha/vit = 130 ha

Sipërfaqe totale 130 ha+4 ha dhe jo sa shënohet 2 ha +4 ha.

e. Kuntrata është e pa noterizuar e pa regjistruar në ZVRPP , në kundërshtim me bazën ligjore të mësipërme me Kodin Civil “Kontrata e Qiradhënies Pasuri e Paluajtshme “Pyje”, në kundërshtim me ligjin nr 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme Me këto mangësi në dokumentacione,pasaktësi e parregullsi në përmbajtje, kontrata nr, datë 29.04.2008, ka qënë e domosdoshme të shfuqizohet, të saktësohet dhe rivlerësohet korrektësisht (Trajtuar hollësisht në faqet 291-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa të rishqyrtojë, saktësojë, eliminojë mangësitë në dokumentacione, pasaktësitë e parregullsitë në përmbajtje, të kontratës nr, datë 29.04.2008 lidhur ndërmjet ish-Komunës Synej me subjektin ”X”, shpk Tiranë, dhe pas këtyre masave ta rivlerësojë atë korrektësisht nga pikëpamja e plotësimit të detyrimeve deri në momentin aktual.

Menjëherë

34. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Golem ka munguar administrimi marrja në inventarin kontabël, menaxhimi i ujit për ujitje dhe akuakulturë dhe vënia në efikasitet të aseteve të llojit vepra ujore, për 6 rezervuar të cilët përdoren nga persona të caktuar për peshkim e akuakulturë, më marrëveshje të parregullta dhe me zaptim pa marrëveshje, me sipërfaqe totale **637,000 m²** për të cilat mungon informacioni sa janë dhënë me marrëveshje të nënshkruara për peshkim e akuakulturë nga ish MMPAU; apo nga ish Shoqatat e Përdorimit të Ujit (SHPU) apo ish-Organizatave të Përdorimit të Ujit (OPU), që përveç pengesave në përdorimin e ujit për ujitje sipas destinacionit parësor, për rezervuarin Kryemedhenj identifikohet i zaptuar nga personi që pretendon pronësi por i pa pajisur me titullin, mosveprime që kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e ish-Komunës Golem, Bashkisë **në vlerën 600,800 lekë** nga mosvendosja e qerasë përdorimi pa qera, në kundërshtim me pikat 1, dhe 6/II germa (b) të VKM Nr. 135, datë 8.3.2006 “Për

Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, llogaritur e pasqyruar në tabelën “**Identifikimi, efienca e funksionit parësor ujitës dhe përdorimi për funksion dytësor akuakulturë me Akt marrëveshje për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Golem Tabela nr.2**” (Trajtuar hollësisht ne faqet 293-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Golem të marrë masa e të verë nën administrimin, menaxhojë me efienca, sipas destinacionit kryesor për ujitje, dhe sekondar akuakulturë, asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesoret përkatës, **si sistemet ujitëse stacione e troje të tyre, monitorimin e funksionit ujitës të 6 rezervuarve**, të identifikojë, rishqyrtoje, administroje dhe vlerësojë marrëveshjet apo kontratat e parregullta të lidhura më parë nga ish Ministria e Mjedisit apo Shoqatat, si dhe përfshijë e rregjistrojë në inventarin kontabël të Bashkisë asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesoret përkatës të 6 rezervuarve, sipas tabelës emërtuar: “Identifikimi, efienca e funksionit parësor ujitës dhe përdorimi për funksion dytësor akuakulturë me Akt marrëveshje për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Golem Tabela nr.2”.

34.2. Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Golem të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin **e vlerës 600,800 lekë** si qera e munguar, që i përket përdorimit të rezervuarve pa titull pronësi e pa marrëveshje përdorimi për ushtrim aktivitet akuakulture dhe në pengim të funksionit kryesor ujitje; në kundërshtim me pikat 1, dhe 6/II germa (b) të VKM nr. 135, datë 8.3.2006 “Për Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, llogaritur pasqyruar në tabelën emërtuar: **Identifikimi, efienca e funksionit parësor ujitës dhe përdorimi për funksion dytësor akuakulturë me Akt marrëveshje për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Golem Tabela nr.2**”.

Menjëherë

35. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuana Helmas, aktualisht NJA Bashkia Kavajë, prej viteve 2012-2013 në baze të nenit 8, ligji 8312, datë 26.3.1998 “Për Tokat bujqësore të pa Ndara”, pika 4 e VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për Tokat bujqësore të pa Ndara”, të ndryshuar Udhëzimit MBUMK nr.3, datë 16.05.2007 ka lidhur 5 kontrata qiradhënie toke bujqësore, **me mangësi në përmbajtje dhe formë, me pasaktësi në sipërfaqe dhe në vlerën e nivelit të qirasë vjetore, si dhe të pa noterizuara e pa regjistruara në ZVRPP, për sipërfaqen 78625 m² ose 7,8625 ha për kultivim drurësh shumë vjeçar ullishte, me vlerë vjetore qiraje 72,860 lekë, për të cilat nga mungesa e monitorimit dhe zbatimit të kontratave për 5 vitet 2012-2016 është krijuar dëmi ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën 88,110 lekë nga mos pagesa në kohë e qirasë, në kundërshtim me bazën ligjore të mësipërme me Kodin Civil “Kontrata e Qiradhënies Pasuri e Paluajtshme “Tokë bujqësore”, ligjin nr 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Kontratat e Qiradhënies Tokës Bujqësore menaxhimi monitorimi i zbatimit dhe likuidimi i detyrimeve v.2012-2016 Ish-Komuna Helmas Kavajë**”(Trajtuar hollësisht ne faqet 288-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

35.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Helmas të marrë masa të rishkruajë e plotësojë në formatin e duhur ligjor, të eliminohen pasaktësitë në sipërfaqet dhe në vlerën e nivelit të qirasë vjetore, si dhe të noterizojë dhe të regjistrojë në ZVRPP 5 Kontratat e tokës bujqësore dhenë me qira nga ish-komuna Helmas në sipërfaqen prej **78625 m² ose 7,8625 ha** për kultivim drurësh shumë vjeçar ullishte me afat 99 vjet.

Menjëherë

36. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Helmas ka munguar administrimi marrja në inventarin kontabël, menaxhimi i ujit për ujitje dhe akuakulturë dhe vënia në efikasitet të aseteve të llojit vepra ujore, për 10 rezervuar të cilët përdoren nga persona të caktuar për peshkim e akuakulturë, me marrëveshje të parregullta me afate deri 10 vjet konkretisht: 6 rezervuar me sipërfaqe totale 400 000 m² janë dhënë me marrëveshje të nënshkruara nga 20.5.2007– deri 3.07.2012, me afate zgjatje deri 17.01.2017-02.07.20 nga ish Kryetari OPU Çetë- Helmës, z. A A dhe 1 rezervuar të Ish Bordit me sipërfaqe 110 000 m² prej të cilëve 4 rezervuar të ish-Komunës me sipërfaqe totale 62,000 m² dhe 2 rezervuar të Ish Bordit me sipërfaqe 338 000 m², me tarifa vjetore 5000 lekë – 10000 deri 30 000 lekë në vit, të cilët kanë paguar në ish OPU vetëm një qiramarrës **30 000 lekë** për gjithë 5 vjetarin, ndërsa 4 rezervuar me sipërfaqe 242000 m² janë zaptuar pa kontrata, prej viteve 2012, e vazhdim, që përveç pengesave në përdorimin e ujit për ujitje sipas destinacionit parësor, kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e ish-Komunës Helmas **Bashkisë në vlerën 5,934,000 lekë** nga vendosja e qerasë në nivele të ulta përdorimi pa qera dhe mos likuidimi i detyrimeve, në kundërshtim me pikat 1, dhe 6/II germa (b) të VKM Nr. 135, datë 8.3.2006 “Për Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, llogaritur pasqyruar në tabelën emërtuar: **“Akt marrëveshjet për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Helmas Tabela nr.2”**.

Gjithashtu nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet, mos zbatimi i planeve të Menaxhim-Mbarështrimit të Fondit pyjor-kullor për periudhën 2013-korrik 2015 deri 2016 të sipërfaqes prej 525.8 ha kullotë janë krijuar me të ardhura të munguara dhe dëmi ekonomik në vlerën prej **1,300,320 lekë**, ndarë: **806,198 lekë** për periudhën 2013-30.7.2015 dhe **494,122 lekë** për periudhën 30.7.2015-2016, **si nivel qiraje e munguar**, në kundërshtim ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në kundërshtim me pikën 7 dhe 17 të Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr 7531, datë 28.12.2015”, dhe me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 (*Trajtuar hollësisht në faqet 288-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

36.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Helmas të marrë masa e të verë nën administrimin, menaxhojë me efikasitet, sipas destinacionit kryesor për ujitje, dhe sekondar akuakulturë, asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesoret përkatës, **si sistemet ujitëse stacione e troje të tyre, monitorimin e funksionit ujitës** të 10 rezervuarve, të rishqyrtoje, administroje dhe vlerësojë marrëveshjet apo kontratat e parregullta të lidhura më parë nga ish Ministria e Mjedisit apo Shoqatat, si dhe përfshijë e regjistrojë në inventarin kontabël të Bashkisë asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesoret përkatës të 10 rezervuarve, sipas tabelës emërtuar: **“Akt marrëveshjet për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Helmas Tabela nr.2”**.

Menjëherë

36.2.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Helmas të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin **-Të vlerës 5,934,000 lekë** nga vendosja e qerasë në nivele të ulta përdorimi pa qera, dhe moslikuidimi që i përket përdorimit të rezervuarve pa titull pronësi e pa marrëveshje përdorimi e mosplotësim të marrëveshjeve për ushtrim aktivitet akuakulturë dhe në pengim të funksionit kryesor ujitje; në kundërshtim me pikat 1, dhe 6/II germa (b) të VKM nr. 135, datë 8.3.2006 “Për Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”, llogaritur pasqyruar në tabelën emërtuar: **“Akt marrëveshjet për dhënie me qira vjetore të rezervuarve dhe zaptimet e rezervuarve për akuakulturë ish-Komuna Helmas Tabela nr.2”**.

Menjëherë

36.3.Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Helmas të marrë masa për vënien nën administrim dhe në efikasitet, dhe zbatimin e planeve të Menaxhim-Mbarështrimit të Fondit pyjor-kullor në sipërfaqen 924,89 ha ndarë prej 525.8 ha kullotë, 310,8 ha pyje dhe 88,29 ha tokë inproduktive pyjore si dhe të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për të ardhura të munguara dhe dëmin ekonomik në vlerën prej **1,300,320 lekë**, ndarë: **806,198 lekë** për periudhën 2013-30.7.2015 dhe **494,122 lekë** për periudhën 30.7.2015-2016, *si nivel qiraje e munguar*, të krijuar nga mos menaxhimi i 525.8 ha kullotë.

Menjëherë

37. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Luz i Vogël, aktualisht NJA Bashkia Kavajë, prej viteve 2012-2013, e më parë nuk ka informacion, apo identifikuar e disponuar Kontratën me firmën "X", me objekt kultivim ulliri dhënie nga Ministria përkatëse të sipërfaqes prej **152 ha tokë** e pandarë ndodhur në administrim e juridiksion të komunës, NJA Luz i vogël, si dhe nuk disponon asnjë informacion lidhur me ecurinë e kësaj kontrate, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me pikën 7 dhe 17 të urdhrin të ministrit të Mjedisit nr 7531, datë 28.12.2015", ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", me nenet 801-805 të Kodit Civil, në kundërshtim me bazën ligjore të mësipërme me Kodin Civil "Kontrata e Qiradhënies Pasuri e Paluajtshme "Tokë bujqësore", me nenin 8, ligji 8312, datë 26.3.1998 "Për Tokat bujqësore të pa Ndara", pika 4 e VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për Tokat bujqësore të pa Ndara", të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 298-302 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

37.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Luz i Vogël të marrë masa të identifikojë, administrojë e disponojë Kontratën me firmën "X", me objekt kultivim ulliri dhënie nga Ministria përkatëse të sipërfaqes prej **152 ha tokë** e pandarë, ndodhur në administrim e juridiksion të ish-komunës, NJA Luz i vogël, si dhe të disponojë informacion e plotë lidhur me ecurinë e kësaj kontrate, plotësimin e detyrimeve të palëve si dhe trajtimin në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Menjëherë

38. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Luzi i Vogël, ka munguar ushtrimi i kontrollit të territorit administrimi menaxhimi i tokave bujqësore të pandara dhe janë zaptuar **1,5 ha** tokë bujqësore e pandarë me ndërtime pa leje sipërfaqe për të cilën nuk identifikohet titulli i pronësisë mbi tokën etj, dhe nuk informohet gjendja dhe ecuria e procesit ligjor, gjendje kjo që ka shkaktuar të ardhura të munguara dhe dem ekonomik nga përdorimi i jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie, *gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9244 "Për mbrojtjen e Tokës" të ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 298-302 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

38.1.Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Luzi i Vogël të marrë masa e të verë nën administrimin sipërfaqen e zaptuar **1,5 ha** tokë bujqësore e pandarë me ndërtime pa leje sipërfaqe të identifikojë titullin i pronësisë mbi tokën etj, të informojë gjendjen dhe ecuria e procesit ligjor, si dhe pas verifikimit kontrollit territorit dhe identifikimit të statusit juridik të tokës bujqësore zënë nga ndërtime të jashtë ligjshme, *të bëhen llogaritjet e vlerës së nivelit të qerasë të munguar pa llogaritur dhe të pa arkëtuar*.

Menjëherë

39. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Luz i Vogël ka në pronësi një fond pyjor prej 30 ha me strukturë, 7,5 ha kullotë, 19,7 ha pyll dhe 5,44 ha tokë inproduktive, asete për të cilat nuk disponohet e nuk jepet asnjë e dhënë për vënien në efikasitet dhe për të ardhurat e vjela prej tyre, gjendje kjo me kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar dhe me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, "Për Përcaktimin e

procedurave dhe të Kriteve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim (*Trajtuar hollësisht ne faqet 298-302 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

39.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Luzi i Vogël të marrë masa të verë nën administrimin e të menaxhojë sipas funksionit fondin pyjor në pronësi prej **30 ha** me strukturë: 7,5 ha kullotë, 19,7 ha pyll dhe 5,44 ha tokë inproduktive.

Menjëherë

40. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Luzi i Vogël ka munguar administrimi menaxhimi dhe vënia në efikasitet të aseteve të llojit vepra ujore, rezervuarit Beden me sipërfaqe **50,000 m²** së bashku me skemat ujitëse i cili nuk është përfshirë në inventarin kontabël të ish- Komunës dhe të Bashkisë, nuk është kryer inventarizimi fizik i rezervuarit dhe aksesoreve përkatës, **si sistemeve ujitëse stacione e troje të tyre, monitorimi e funksionit ujitës, për periudhën 2013,2014, dhe deri 30.7.2015 dhe deri në v.2016** nuk janë administruar nga ish Komuna kontratat apo marrëveshjet për përdorim peshkimi e akuakulturë (si funksion i dytë pas atij kryesor të ujitjes) të lidhura nga Ish Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të ujërave apo dhe nga Shoqatat e Përdorimit të Ujit (SHPU. Konkretisht rezervuari përdoret sipas informacionit për peshkim prej 10 vitesh nga qytetari R H, për të cilën Komuna nuk disponon e as ka kërkuar të ardhurat e munguara dhe dëmin ekonomik në vlerën prej **500, 000 lekë** (50.000 m² x 2/lekë/ m²/vit x 5 vjet = (Ilogaritur nga vendosja e qerasë në nivele të ulta përdorimi pa qera, dhe mos likuidimi në kundërshtim me pikat 1, dhe 6/II germa (b) të VKM Nr. 135, datë 8.3.2006 “Për Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive”. Mos marrja në inventar dhe mosvënia nën administrim ka sjellë mungesën e vënies në efikasitet pra të përdorimit të ujit për ujitje, pasi nuk është vendosur lidhja me organizatën ekzistuese apo dhe krijimi i shoqatës së përdorimit të ujit,(ShPU) mosveprim ky në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999,”Për Ujitjen dhe Kullimin“, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht ne faqet 298-302 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

40.1.Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Luzi i Vogël të marrë masa e të verë nën administrim, menaxhojë me efikasitet, sipas destinacionit përkatës për ujitje, asetet e llojit vepra ujore me skemat dhe aksesoret përkatës, sidomos të rezervuarit “Beden” me sipërfaqe **50,000 m²** së bashku me skemat ujitëse dhe cili ta përfshijë e regjistrojë në inventarin kontabël të Bashkisë.

Menjëherë

40.2.Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Luzi i Vogël të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin **e vlerës 500,000 lekë** ndaj qytetarit R H, si qera e munguar, që i përket përdorimit të rezervuarve pa titull pronësi e pa marrëveshje përdorimi për ushtrim aktivitet akuakulture dhe në pengim të funksionit kryesor ujitje.

Menjëherë

41. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë në secilin prej viteve 2015 dhe 2016, ka një strukturë të Inspektoratit e Mbrojtjes së territorit Vendor (IMTV) të paplotësuar dhe të pa argumentuar, pasi në vitin 2015 nga 5 inspektorë të përcaktuar ka plotësuar 3 inspektorë, në 2016 nga 4 inspektorë të përcaktuar ka plotësuar vetëm 3 inspektorë, ndonëse territori është zgjeruar pas reformës me përfshirjen e 4 komunave, që ka sjellë si pasojë mungesën e ushtrimit tërësor të kontrollit të territorit, përmbushjes së detyrave funksionale lidhur me marrjen nën administrim, ruajtjen dhe administrimin e aseteve resurseve, pasurive sipas llojeve në pronësi shtrirë në juridiksionin territorial të Bashkisë Kavajë, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”

Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Trajtuar hollësisht ne faqet 302-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

41.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, Kryetari, të marrë masa të ndërtojë një strukturë funksionale të IMTV, të argumentuar dhe ta plotësojë atë me numrin e nevojshëm të inspektorëve, bazuar në gjerësinë shtrirjen dhe madhësinë e territorit nën administrim me synim ushtrimin tërësor të kontrollit të territorit, dhe të përmbushjes së detyrave funksionale lidhur me marrjen nën administrim, ruajtjen dhe administrimin e aseteve resurseve, pasurive sipas llojeve në pronësi shtrirë në juridiksionin territorial të Bashkisë Kavajë.

Menjëherë

42. Gjetje nga auditimi: IMTV për periudhën 2015-2016 nuk ka programe pune të veta dhe nuk ka programe bashkëpunimi, shkëmbime informacioni ndërmjet IMTV, Drejtorisë Planifikimit Zhvillimit Territorit (Drejtoria PZHT) dhe as nuk ka paraqitje website lidhur me publikimin e lejeve të sheshit dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të përdorimit si dhe lidhur me zbatimin ligjor të afateve dhe kushteve të lejeve, mosveprim që ka sjellë si pasojë mungesën e bashkëpunimit ndërmjet Strukturave të Bashkisë Kavajë, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” (Trajtuar hollësisht ne faqet302-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

42.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, IMTV të hartojë dhe miratojë tek Kryetari programet vjetorë të kontrollit të territorit duke përfshirë bashkëpunimin me strukturat e tjera të Bashkisë Kavajë dhe të vendosin shkëmbime informacioni ndërmjet IMTV, Drejtorisë Planifikimit Zhvillimit Territorit (Drejtoria PZHT), të përdorë si burime paraqitjen në *web site* të publikimit e lejeve të sheshit dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të përdorimit lidhur me zbatimin ligjor të të parametrave afateve dhe kushteve të lejeve, me synim përmbushjen e funksionit të Kontrollit të territorit.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

43. Gjetje nga auditimi: IMTV Kavajë lidhur me marrjen e vendimeve dhe zbatimin për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi nuk ka një evidentim të kontrollit të territorit mbi gjendjen e ndërtimeve pa leje për vitet 2015-2016, mungesë që nuk na lejon të shprehim opinionin për vendimmarrjen në lidhje me ushtrimin e plotë të kontrollit të territorit të Bashkisë Kavajë.

Për periudhën 2015-2016 nga IMTV Kavajë janë marrë gjithsej **35 vendime** për prishje objekteve përkatësisht **6 ne v.2015 dhe 29 në vitin 2016** ndërsa janë zbatuar, ekzekutuar vetëm për **19 objekte janë prishur**, ndërsa **16 nuk janë ekzekutuar**, prej të cilëve 2 për shkak të procesit të legalizimit dhe **14 nuk janë zbatuar vendimet për prishje**, çka tregon performancë të pamjaftueshme të punës për kontrollin e territorit, gjendje kjo në kundërshtim me Ligjin nr.10119 neni 83, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” neni 39 neni 52/1 germa “ë”, “ii” dhe me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Vendimet e Prishjeve për periudhën 2015-2016 nga IVMT Bashkia Kavajë Tabela nr.1**”, bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht ne faqet 302-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

43.1.Rekomandim: IMTV Bashkia Kavajë të marrë masa për evidentim të plotë të kontrollit të territorit mbi gjendjen e ndërtimeve pa leje si dhe të marrë masa në zbatim të menjëhershëm të **14 vendimeve për prishje të marra në vitet 2015-2016, por të pa ekzekutuara, duke dokumentuar përfundimin e procesit të prishjes** pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Vendimet e Prishjeve për periudhën 2015-2016 nga IVMT Bashkia Kavajë Tabela nr.1**”,

Menjëherë

44. Gjetje nga auditimi: Nga IMTV Bashkia Kavajë, për periudhën 2015-2016 janë mbajtur **42 procesverbale vendime pezullimi** prej të cilave **10 vendime për vitin 2015 dhe 32 vendime për vitin 2016**, për shkaqe se nga kontrollet e IMTV ndërtimet kanë rezultuar me shkelje dhe në kundërshtim me Ligjin nr.10119 neni 83, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” neni 39 neni 52/1 52/3 germat “ë”,”ii” dhe me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, dhe nga ana e IMTV zbatimi i procedurave të ekzekutimit dhe ecurisë së vendimeve të pezullimit tregon për ngadalësi lidhur me gjendjen e lartë të **22 vendimeve të kallëzuara në Prokurori** dhe prej mbi një vit dhe mungon informacioni, lidhur **18 vendime të mbetura në proces dhe pa veprim**, (prej të cilave 9 vendime pezullimi të mbetura në proces, dhe 9 vendime pezullimi të mbetura pa veprim) pra për më se 1 vit nuk është vepruar, çka tregon për ngadalësi dhe mungesë transparence, gjendje kjo në kundërshtim me Ligjin nr.10119 neni 83, ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” neni 39 neni 52/1 germat “ë”,”ii” dhe me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, pasqyruar në tabelën emërtuar: **“Vendimet e Pezullimit dhe ecuria e ekzekutimit procedurave për periudhën 2015-2016 nga IVMT Bashkia Kavajë Tabela nr.3”**, bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht në faqet 302-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

44.1.Rekomandim: IMTV Bashkia Kavajë të marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e i procedurave të ekzekutimit dhe ecurisë së vendimeve të pezullimit konkretisht lidhur me gjendjen e lartë të **22 vendimeve të kallëzuara në Prokurori** për të cilat prej mbi një vit mungon informacioni, lidhur **18 vendime të mbetura në proces dhe pa veprim**, (prej të cilave 9 vendime pezullimi të mbetura në proces dhe 9 vendime pezullimi të mbetura pa veprim) pra për më se 1 vit nuk është vepruar, çka tregon për ngadalësi dhe mungesë transparence të këtij institucioni.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

45. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë, ish-Kryetari dhe Drejtorja e Kontrollit, Zhvillimit, Urbanistik e Pronave, ka dhënë lejen nr. 05, datë 11.01.2016, në emër të Banoreve të një Pallati ndodhur në Lagjen nr.4, cituar: Vërtetim objekti pranimit i kërkesës për deklaram Rikonstruksion ballkoni me kolona beton arme (Ndërrhyrje për shkak të shembjes së ballkonit në katin e III të Pallatit dhe rrezik shembje në Katet e tjera”

Nga auditimi rezulton se kjo lejë është e parregullt pasi ndërhyrja është në strukturën e projektit ekzistues të pallatit, prandaj trajtimi duhej shoqëruar me studim e projektin përkatës duke ruajtur sipërfaqen hije të ballkonit mbi truall e në vazhdim duhej bërë edhe piktimi. Pra vërtetimi për pranimitin e deklaratës dhënë në këtë rast nuk është dokumenti i duhur ligjor, pra është në kundërshtim me ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin e Territorit” dhe me rregulloren nr.408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”. Qytetarit prej 1 viti nuk i është kthyer përgjigje për ankesën, mosveprime në kundërshtim me afatin ligjor 1 muajor pra me KPA; që ngarkon me përgjegjësi, krahas strukturave të tjera znj. Matilda Peza, me detyre Drejtore e Drejtorisë Ligjore, në cilësinë e shpërndarjes së Korrespondencës (Trajtuar hollësisht në faqet 312-314 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

45.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë, Kryetari me strukturat përkatëse IMTV, Polici Bashkiake, dhe Drejtorinë Urbanistike, të marrin masa për vënien në dispozicion të mjeteve përkatëse për ekzekutimin e Vendimit nr.28, datë 19.12.2016 “Për Prishjen e Objektivit”, filluar punimet sipas lejes së parregullt nr.5, datë 11.01.2016, dhënë në emër të Banoreve të një Pallati ndodhur në Lagjen nr.4, cituar: Vërtetim objekti pranimit i kërkesës për deklaram Rikonstruksion ballkoni me kolona beton arme (Ndërrhyrje për shkak të shembjes së ballkonit në katin e III të Pallatit dhe rrezik shembje në Katet e tjera”, me pasojë shkeljen e konstruksionit daljen jashtë parametrave në sipërfaqen tepër 12 m², pronësi publike, me themele mbi sipërfaqen ekzistuese hije të 14 m², të ballkonit, duke bërë zgjidhjen e duhur ligjore e teknike, si dhe të kthejë përgjigje ankuesve brenda afateve të KPA. **Menjëherë**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 97,473,180 lekë, si më poshtë:***

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, procedurat e ndjekura për administrimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare të transferuara pa pagesë nga Rezervat e Shtetit për familjet në nevojë të përmbytura, janë kryer në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur (*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen e urdhër pagesave në shumën **433,263 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit me qëllim arkëtimin e dëmit e vjelja detyrimit nga 10 anëtarët e Komisionit të pritjes, administrimit dhe shpërndarjes së ndihmave humanitare (*pako ndihma*), për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale, pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur.

Deri më 31.12.2017

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, në inventarin e pasurisë materiale inventar ekonomik dhe inventar i imët për periudha raportuese 2015 njësia vartësisë (*Arsimi*) e periudha raportuese 2016 njësia administrative (*Helmas*) rezultuan diferenca në mungesë nga gjendja fizike e pasqyruar në fletëinventar e krahasuar me gjendja kontabile, në mospërputhje ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*”, neni 7 “*Inventari i aktiveve e detyrimeve*”; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu IV “*Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve*”(Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 të Raporti Përfundimtar i Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrje e urdhër pagesave në shumën **2,020,644 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit me qëllim arkëtimin e dëmit e vjeljen e detyrimit nga 18 persona përgjegjës material në njësia e vartësisë (*Arsimi*) dhe nga 7 persona përgjegjës material në njësia administrative (*Helmas*), për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale, pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur.

Deri më 31.12.2017

3. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, nga magazina e njësisë shpenzuese Bashkia Kavajë është shpërndarë sasia e karburantit prej **18,414 litra** gazoil në njësitë administrative që nuk kanë në organikë mjet transporti, në këto kushte tërheqja dhe përdorimi i karburantit nga punonjës e persona me dokumente të pa justifikuar,

me normativa konsumi të pa miratuara me vendim nga Këshilli i Bashkisë (*Trajtuar hollësisht në faqet 312-319 të Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen e urdhër pagesës në shumën **3,014,731 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e detyrimit nga 4 personat përgjegjës me detyrë administratorë në njësitë administrative Golem, Luzi i Vogël, Synej, Helmas për mungesë në zbatimin e përgjegjësive funksionale, pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur.

Deri më 31.12.2017

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, janë kryer pagesa nëpërmjet 5 Urdhra shpenzime për likuidimin e faturave për blerje materiale të pa shoqëruara me dokumenta justifikuese dhe jashtë afatit të periudhës raportuese, në mospërputhje me kushtet e kontratës së lidhur midis palëve dhe pika 5 e Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*”. (*Trajtuar hollësisht në faqet 87-110 , 312-319 të Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

4.1Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe kryerjen e ndalesës në shumën **2,071,229 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit dhe vjeljen e detyrimit për 5 urdhra shpenzimi nga 3 subjekte të pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur.

Deri më 31.12.2017

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit u konstatua se, nga njësia administrative Helmas (ish/Komuna) nuk janë përlloritur të ardhura mbi bazën e sipërfaqes së truallit që është miratuar me leje shfrytëzimi me objekt “*karier gipsi dhe albastrë*”, ndërsa janë përlloritur me diferencë ku njësia administrative Helmas nuk ka mbajtur procesverbal, apo aktrakordim për sipërfaqen e shfrytëzuar, sasinë e prodhuar apo vlerën e të ardhurave që duhet arkëtuar, në mospërputhje me vendim nr.01, datë 05.02.2015 për paketën fiskale periudha raportuese 2015 e VKB nr.8, datë 29.02.2016 Kapitulli I “*taksa mbi truallin*”, pika 1.2, germa (c). (*Trajtuar hollësisht në faqet 312-319 të Raporti Përfundimtar i Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Ekonomike të kërkojë në rrugë ligjore kontabilizimin dhe nxjerrjen e urdhër pagesave në shumën **17,800,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit me qëllim arkëtimin e dëmit e vjeljen e detyrimit nga 4 subjektet sipas lejeve të shfrytëzimit, pasqyruar në aneksin nr.1 bashkëlidhur.

Deri më 31.12.2017

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.1 tek ish rezervat e shtetit*”, me fond limit 8,489,581 lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e “S” shpk, me vlerë të ofertës 6,237,855 lekë, me vlerë më të ulët, me pretendimin se “*Nuk plotëson numrin mesatar prej 35 punonjësish të kërkuar*”, por nga auditimi rezultoi se: ky pretendim i KVO nuk qëndron pasi listëpagesat e konfirmuara nga administrata tatimore tregojnë qartë se kjo shoqëri e plotëson numrin e fuqisë puntore prej 35 punëtorësh, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **525,241 lekë dëm ekonomik**.

Për më tepër, KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e BOE “X shpk & Y”, me vlerë më të lartë, duke mos plotësuar kërkesat e DST. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, nenin 20, “Mosdiskriminimi” (*Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **525,241 lekë** nga KVO e përbërë nga P.Xh., A.M, F.K, J. Q dhe M. H, me nga **105,048 lekë secili** për vlerësim të gabuar të ofertave ekonomike me pasojë dëm ekonomik.

Deri më 31.12.2017

7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt **“Rehabilitimi i banesave në bashkëpronësi”**, me fond limit 7,954,060 lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e “Z” shpk, me vlerë të ofertës 5,389,345 lekë, *me vlerë më të ulët*, me pretendimin se *“Nuk plotëson numrin mesatar prej 35 punonjësish të kërkuar”*, por nga auditimi rezultoi se: ky pretendim i KVO nuk qëndron pasi listëpagesat e konfirmuara nga administrata tatimore tregojnë qartë se kjo shoqëri e plotëson numrin e fuqisë punëtore prej 35 punëtorësh, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **1,126,677 lekë dëm ekonomik**. Për më tepër, KVO ka vepruar me **dy standarde** pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e BOE “M shpk & Sshpk” për arsye se ka pasur mangësi në plotësimin e kërkesave të DST.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, nenin 20, “Mosdiskriminimi” (*Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,126,677 lekë** nga KVO e përbërë nga P.Xh, A. M, F. K, J. Q dhe M.H, me nga **225,335 lekë secili** për vlerësim të gabuar të oferave ekonomike me pasojë dëm ekonomik.

Deri më 31.12.2017

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt **“Instalimi i sistemit ngrohje ftohje në godinën e Bashkisë Kavajë”**, me fond limit 7,551,354 lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e OE “Z” shpk, *me vlerë më të ulët*, me pretendimin se: *“Nuk ka punë të ngjashme me objektin e prokuruar”*, por nga auditimi rezultoi se ky pretendim i KVO nuk qëndrën pasi shoqëria “Z” shpk ne bazë të kontratave të paraqitura e plotëson këtë kriter, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **789,422 lekë dëm ekonomik**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, nenin 20, “Mosdiskriminimi” dhe nenin 46. (*Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **789,422 lekë** nga KVO e përbërë nga P.Xh, A. M, F. K, J. Q dhe M. H, me nga **157,884 lekë secili** për vlerësim të gabuar të oferave ekonomike me pasojë dëm ekonomik.

Deri më 31.12.2017

9. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt **“Furnizimi me ushqime për kopshte, çerdhe dhe konvikte”** me fond limit 9,109,003 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: Vendosija e gabuar e kriterëve të veçanta për kualifikim nga ana e NJHDT **kanë shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender duke ndikuar që KVO të s’kualifikojë padrejtësisht operator ekonomik me vlerë më të ulët**, konkretisht: Është skualifikuar OE “A” shpk me vlerë të ofertës 7,628,808 lekë, pasi nuk ka *“Një pikë shitje jo më larg se 10 km nga qyteti i Kavajës”*. Kërkesë e cila, siç është sqaruar edhe në pjesën e dokumenteve të tenderit, nuk ka përmbushur qëllimet kryesore të LPP të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, pasi është një kërkesë diskriminuese dhe pengon

konkurrencën. Për me tepër, KVO ka përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave për arsye se edhe operatori ekonomik i shpallur fitues “XYZ” shpk nuk ka një pikë shitje brenda 10 km nga qyteti i Kavajës. Nga veprimet e mësipërme të NJHDT dhe KVO i është shkaktuar buxhetit të shtetit një **dëm ekonomik në vlerën 326,412 lekë**, për arsye se kanë vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c dhe nenin 20, “Mosdiskriminimi”, neni 46 pikat (1) dhe (3). (*Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **326,412 lekë** nga NJHDT e përbërë nga E. A, M.D, Xh. M dhe KVO e përbërë nga P. X, A. M, F.K, J.Q dhe M H me nga **40,801 lekë secili** për vendosje të kriterëve diskriminues dhe vlerësim të gabuar të ofrave ekonomike me pasojë dëm ekonomik.

Deri më 31.12.2017

10. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Furnizimi me materiale elektrike për ndricim rrugor*”, me fond limit 7,350,950 lekë” zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e ofertave, pasi të 4 (katërt) operatorët ekonomikë pjesëmarrës në garë OE “ZY” shpk me vlerë të ofertës 5,987,550 lekë, OE “Z” shpk me vlerë të ofertës 6,477,450 lekë, OE “D” shpk me vlerë të ofertës 7,121,600 lekë dhe OE “PI” shpk me vlerë të ofertës 7,237,700 lekë, kanë mangësi në plotësimin e “Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit”, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë, pasi KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “P” shpk, *me vlerë më të lartë*, duke krijuar **dëmin ekonomik në vlerën 1,250,150 lekë**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (d) dhe (dh), Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, nenin 20, “Mosdiskriminimi” dhe nenin 46 (*Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Bashkia Kavajë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,250,150 lekë** nga KVO e përbërë nga P. X, A.M, F. K, J.Q dhe M. H me nga **250,030 lekë secili** për vlerësim të gabuar të ofrave ekonomike me pasojë dëm ekonomik.

Deri më 31.12.2017

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagave dhe shpërblimeve në ish-komunat Golem, Synej dhe Helams (Bashka Kavajë) për periudhën janar 2013-6/mujori 2015, u konstatua se: janë bërë pagesa të paligjshme për shpërblimin e 36 këshilltarëve të ish-komunave, të cilët janë shpërblyer për punë të pakryer pasi nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të këshillit, duke vepruar në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, pikën 2 dhe 9 të nenit 31 të ligjit 8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, çka kanë sjellë përfitim të padrejtë të vlerës totale **944,070 lekë dëm ekonomik** për të 3 ish-komunat (*Trajtuar në faqet 77-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimit **944,070 lekë**, nga 31 ish-këshilltarët të këshillit të ish-komunave, konkretisht për ish-komunat: Golem në vlerën **572,400 lekë**, Synej në vlerën **241,800 lekë** dhe Helmas në vlerën **129,870 lekë**, sipas listave emërore të pasqyruara në faqet 312-322 të raportit të auditimit.

Deri më 31.12.2017

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të bankës në ish-komunën Helmas (Bashkia Kavajë) për periudhën 2013-6/mujori 2015, u konstatuan shpenzime të paligjshme për përdorimin e telefonisë celulare për 4 ish-punonjës në vlerën **231,000 lekë dëm ekonomik**, duke vepruar në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publikë” dhe VKM nr. 545, datë 11.08.2011, lidhja nr.1 (*Trajtuar në faqet 312-322 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Bashkia Kavajë (për ish-komunën Helmas), të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **231,000 lekë** për shpenzime celulare të paligjshme, të përfituara nga: S.G. për vlerën **114,000 lekë**, V. N për vlerën **54,000 lekë**, R I për vlerën **57,000 lekë** dhe M. K për vlerën **6,000 lekë**.

Deri më 31.12.2017

13. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, zhvilluar në vitin 2016, me kohëzgjatje 3 vjet, si rezultat i llogaritjeve tepër të shpenzimeve për pagën e fuqisë punëtore, hartuar në analizën e kostos nga vet kontraktori “A” sh.p.k me NIPT është përfituar tepër padrejtësisht prej tij për periudhën prill-dhjetor 2016 vlera 6,496,570 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kavajë. Për periudhën në vazhdim të kontratës, janar 2017-mars 2019 vlera që pritet të përfitohet padrejtësisht nga operatori i mësipërm është 19,489,710 lekë.

Për procesin e lagies së rrugëve për periudhën prill-dhjetor 2016, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kavajë është llogaritur pagesë për kontraktorin “a” për shërbim të pakryer prej tij, në vlerën 1,854,174 lekë, dëm ekonomik, prej së cilës 1,173,005 lekë likuiduar për periudhën prill-gusht 2016 dhe vlera 681,169 lekë ende e pa likuiduar nga Bashkia Kavajë.

Për procesin e fshirjes me makinë teknologjike për periudhën prill-dhjetor 2016, është llogaritur pagesë për kontraktorin “A” sh.p.k me NIPT për shërbim të pakryer prej tij, në vlerën 2,312,016 lekë dëm ekonomik, prej së cilës 1,104,576 lekë likuiduar për periudhën prill-gusht 2016 dhe vlera 1,207,440 ende e pa likuiduar nga Bashkia Kavajë. **Në total për vitin 2016 dëmi ekonomik i shkaktuar është 10,662,760 lekë, prej të cilit vlera 8,774,151 lekë likuiduar dhe vlera 1,888,609 lekë ende e palikuiduar** nga Bashkia Kavajë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 162-225 të Raportit*).

13.1 Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të kërkohet me të gjitha rrugët e mundshme ligjore shlyerja e vlerës **8,774,151 lekë** prej kontraktorit “A” sh.p.k me NIPT, përfituar padrejtësisht tepër prej tij për pagesën e fuqisë punëtore, lagien e rrugëve dhe fshirjen me makinë teknologjike, për periudhën prill-gusht 2016. Të mos likuidohet vlera 1,888,609 lekë llogaritur për pagesë për këto zëra për periudhën shtator-dhjetor 2016. Të rishikohet kontrata 3 vjeçare e lidhur midis Bashkisë Kavajë dhe kontraktorit për periudhën në vazhdim duke përshtatur vlerat e preventivit me ato të analizës së kostos paraqitur nga kontraktori (e pa marrë në analizë kjo e fundit nga Bashkia), në përputhje me legjislacionin në fuqi, për zërin shpenzime për fuqi punëtore, lagien e rrugëve dhe fshirjen me makinë teknologjike.

Deri më 31.12.2017

14.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Synej, Helmas dhe Luz i Vogël”, zhvilluar në vitin 2015 nga Bashkia Kavajë me afat 3 vjeçar, janë planifikuar nevoja për makineri dhe fuqi punëtore më shumë se kapaciteti real i punëve dhe shërbimit të pastrimit të mbeturinave, duke mos vërtetuar se është kryer prej tyre punë konkrete, pasi sasia e mbeturinave të krijuara është më e vogël se kapaciteti i makinerive të kërkuara. Kjo ka shkaktuar, përfitim padrejtësisht nga "E" shpk dhe "U" shpk, në cilësinë e kontraktonit, të vlerës **4,836,613 lekë, dëm ekonomik**, për periudhën prill-dhjetor 2016. Për periudhën e ngelur të kontratës janar 2017-mars 2019

efekti negativ i pritshëm në buxhetin e Bashkisë Kavajë është 14,509,865 lekë . (Trajtuar më hollësisht në faqet 162-225 të Raportit).

14.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të kërkojë me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e vlerës **4,836,613 lekë**, nga kontraktori "E" shpk dhe "U" shpk, përkatësisht me NIPT dhe përfituar padrejtësisht prej tyre. Të rishikohet kontrata. preventivi, analiza e kostos dhe specifikimet teknike duke hequr nga angazhimi në këtë tender dy makinat kamionçinë dhe fuqinë punëtore për to për periudhën e ngelur të kontratës.

Deri më 31.12.2017

15.Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Rilindja”, lagjja nr.1 Kavajë”, zhvilluar në datën 19.08.2016 në hartimin e ofertës ekonomike për makineritë dhe pajisjet, nga BOE “D” & “E” shpk, në cilësinë e kontraktorit, është llogaritur TVSH në vlerën **559,620 lekë, dëm ekonomik**, përfituar padrejtësisht prej tij. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I, me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 8 dhe 9 si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, pika 8.1 dhe 8.3 si dhe me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit (Trajtuar më hollësisht në faqet 162-225 të Raportit në procesverbalin nr.2, datë 26.04.2017).

15.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masa me të gjitha rrugët e mundshme ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **559,620 lekë** nga BOE “D& “E” shpk, përkatësisht me NIPT dhe, në tenderin me objekt “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Rilindja”, lagjja nr.1 Kavajë”.

Deri më 31.12.2017

16.Gjetje nga auditimi Në tenderin me objekt “Pastrim i mbetjeve urbane në fshatrat e Komunës Luz i Vogël”, zhvilluar në vitin 2014, janë planifikuar nevoja për makineri dhe fuqi punëtore më shumë se kapaciteti real i punëve dhe shërbimit të pastrimit të mbeturinave, nuk argumentohet dhe vërtetohet përdorimi i mjetit të dytë për kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, pasi nuk ka realisht mbeturina për dy mjete, por vetëm për një. Në këtë mënyrë pagesa për karburant, lubrifikant dhe mirëmbajtje për llogari të mjetit të dytë, në vlerën **792,100 lekë, përbën dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore, pasi janë shpenzime të pa argumentuara dhe të përfituara padrejtësisht nga operatori ekonomik “Z” shpk, me NIPT, në cilësinë e kontraktorit (Trajtuar në faqet 162-225 të Raportit).

16.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të ndjek të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e vlerës **792,100 lekë** nga operatori ekonomik “Z” shpk, me NIPT, në cilësinë e kontraktorit, përfituar padrejtësisht prej tij.

Deri më 31.12.2017

17. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Pastrimi i mbetjeve urbane në fshatrat e Komunës Synej”, zhvilluar në vitin 2014, janë kryer pagesa për kontraktin “A”, për procesin e punës dhe shërbimit “Grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme”, i cili nuk vërtetohet dhe argumentohet se është kryer nga kontraktori, pasi për kryerjen e këtij procesi në DST nuk është kërkuar mjet nga Autoriteti Kontraktor. Në këtë mënyrë është përfituar tepër padrejtësisht nga operatori ekonomik “A” vlera **437,500 lekë, dëm ekonomik** për buxhetin e njësisë vendore (Trajtuar në faqet 162-225 të Raportit).

17. 1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të ndjek të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e vlerës **437,500 lekë** nga operatori ekonomik “A”, në cilësinë e kontraktorit, përfituar padrejtësisht prej tij.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të konsumit të karburantit në ish Komunën Golem, u konstatua se për vitin 2014 dhe 2015, tre mjete kanë kryer konsum të karburantit **në vlerën 859,576 lekë**, me arsyen e lëvizjes së punonjësve të ndryshëm të administratës nga njësia vendore Golem për Tiranë. Për të gjitha rastet mungon autorizimi i titullarit për punonjësit, urdhri i punës për mjetet, dokumenti për të argumentuar qëllimin e shërbimit, veprime në kundërshtim me pikën 34,35 dhe 36 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në kundërshtim me pikën nr.2 të paragrafit V, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” ku thuhet se “Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij”.UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Si rezultat është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 859,576 lekë**, për të cilin ngarkohet me përgjegjësi z. A. A, ish Kryetar i Komunës Golem për arsye se ka miratuar fletë udhëtimet e drejtuesve të mjeteve, duke shkarkuar kështu nga magazina dhe kontabiliteti vlerën e mësipërme (*Trajtuar në faqet 320-321 të Raportit*).

18.1.Rekomandim: Bashkia Kavajë të ndjek të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e vlerës **859,576 lekë** nga ish Kryetari i Komunës Golem z. A.A.

Deri më 31.12.2017

19. Gjetje nga auditimi:Në objektin “**Rruga e Daljes (Zona Industriale), Rikualifikim i Plotë, (Trotuar, Asphalt), Faza II**”, Bashkia Kavajë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë*, **duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit 2,348,925 lekë pa tvsh për punime të pakryera**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. A.Q, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

19.1.Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për verifikimin e zërave të punimeve të konstatuara me mangësi gjatë inspektimit në terren, kjo përpara marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve të përfunduara. Konkretisht u konstatuan si punime të të pakryera me vlerë **2,348,925 lekë pa tvsh** nga OE “C” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 854/2 prot., datë 16.06.2015 me objekt “**Rruga e Daljes (Zona Industriale), Rikualifikim i Plotë, (Trotuar, Asphalt), Faza II**”, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi:Në objektin “**Rikonstrukcion i Rrugës Fragment i Shëtitorës Nr. 1, (nga Teqja – Rruga Dalëse), Faza III**”, Bashkia Kavajë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë*, **duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit 2,065,500 lekë pa tvsh për punime të pakryera**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të*

Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. A.Sh, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

20.1.Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për verifikimin e zërave të punimeve të konstatuara me mangësi gjatë inspektimit në terren, kjo përpara marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve të përfunduara. Konkretisht u konstatuan si punime të pakryera me vlerë **2,065,500 lekë pa tvsh** nga OE “G” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 257/2 prot., datë 01.02.2016 me objekt “**Rikonstruksion i Rrugës Fragment i Shëtitores Nr. 1, (nga Teqja – Rruga Dalëse), Faza III**, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi:Në objektin “**Rikonstruksion i Rrugëve të Brendshme të Varrezave**”, Bashkia Kavajë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 1,492,379 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik*, nga të cilat vlera **521,190 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 971,189 lekë pa tvsh si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit””, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. K. S, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

21.1.Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,492,379 lekë pa tvsh** nga OE “N” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 646/2 prot., datë 13.05.2015 me objekt “**Rikonstruksion i Rrugëve të Brendshme të Varrezave**”, Bashkia Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi:Në objektin “**Rikonstruksion i Rrugës Lagja Xekaj Deri tek Rruga për Vorozen**”, ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 2,067,150 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik*, nga të cilat vlera **1,653,750 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 413,400 lekë pa tvsh si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin

nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. G.G, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe

kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

22.1.Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,067,150 lekë pa tvsh** nga OE “**K**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 138 prot., datë 12.07.2013 me objekt “**Rikonstruksion i Rrugës Lagja Xekaj Deri tek Rruga për Vorrozen**”, ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rikonstruksion i Rrugës Shehje – Hallull – Vorrozen – Blerimaj dhe i Rrugës Lindje Qendrës Vorrozen**”, ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë*, **duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit 982,400 lekë pa tvsh për punime të pakryera**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Xh. D, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “*Për zbatimin punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

23.1.Rekomandim: Nga Bashkia Kavajë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **982,400 lekë pa tvsh** nga OE “**L**” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 129 prot., datë 20.06.2013 me objekt “**Rikonstruksion i Rrugës Shehje – Hallull – Vorrozen – Blerimaj dhe i Rrugës Lindje Qendrës Vorrozen**”, ish-Komuna Luz i Vogël, Kavajë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Kavajë, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit përbërës të dosjeve të lejeve të ndërtimit (Lejeve zhvillimore) **a.** u konstatuan mangësi dhe shkelje në drejtim të kontrollit të zbatimit të lejeve të ndërtimit lidhur me ecurinë e fazave të procesit të punimeve dhe afatet, për 29 leje prej 43 që kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik në vlerën **826,750 lekë** prej të cilave **108,000 lekë** nga mos kontrolli i kuotës 00, dhe **70,000 lekë** nga mungesa e kontrollit të karabina, **21,000 lekë** mungesa e kontrollit përfundimtar dhe **627,750 lekë vlerë e gjobave** të pa aplikuar nga mos kontrolli në kohë i fazave, në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me neni 52, pika 3 ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin e Territorit”, dhe në kundërshtim me afatet dhe grafikë përcaktuar në lejet përkatëse të ndërtimit, ndarë sipas viteve, vlera prej 125,500 lekë për 2 leje të virit 2015 vlera prej 701,250 lekë për 27 leje të virit 2016 pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Të ardhurat e munguara dhe dëmi ekonomik nga mungesa e kontrollit të zbatimit të LN për v.2015 dhe 2016**”, bashkëlidhur.

24.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit në bashkëpunim me IMTV të marrin masat për ushtrimin e kontrollit të zbatimit të lejeve të ndërtimit lidhur me ecurinë e fazave të procesit të punimeve dhe afatet, për 29 leje prej 43 si dhe masat administrativo–ligjore për arkëtimin e detyrimeve të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik në vlerën **826,750 lekë**, prej të cilave: **108,000 lekë** nga mos kontrolli i

kuotës 00, dhe **70,000 lekë** nga mungesa e kontrollit të karabina, **21,000 lekë** mungesa e kontrollit përfundimtar dhe **627,750 lekë vlerë e gjobave** të pa aplikuar nga mos kontrolli në kohë i fazave, ndarë sipas viteve, vlera prej 125,500 lekë për 2 leje të virit 2015 vlera prej 701,250 lekë për 27 leje të virit 2016 pasqyruar në tabelën emërtuar: **“Të ardhurat e munguara dhe dëmi ekonomik nga mungesa e kontrollit të zbatimit të LN për v.2015 dhe 2016”**

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë (Autoriteti Zhvillimit Territorit),për periudhën 2015-2016 nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban janë zbatuar procedurat ligjore e dhënë **13 leje** përdorimi përkatësisht **10 leje përdorimi** në vitin 2015 dhe **3 leje përdorimi** në vitin 2016,që tregon ecuri e ngadaltë e lëshimit të lejeve të përdorimit, nga mos ndjekja e afateve të lejeve të ndërtimit, theksuar më sipër, pra janë lëshuar leje përdorimi 12 leje përdorimi tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 6 muaj deri në 12 vjet, në kundërshtim me afatet ligjore që kanë shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën nga 450,000-4,500,000 lekë** ndarë: **në vitin 2015** për **10 leje përdorimi** lëshuar tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 6 muaj deri në 12 vjet, në kundërshtim me afatet që kanë shkaktuar **dëmin ekonomik në vlerën nga 350,000-3,500,000 lekë**, duke mos aplikuar vlerën e gjobës, ndërsa në **vitin 2016** për **2 leje përdorimi** tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 3 vjet deri 5 vjet, në kundërshtim me afatet që kanë shkaktuar **dëmit ekonomik në vlerën nga 100,000-1,000,000 lekë**, duke mos aplikuar vlerën e gjobës, në kundërshtim me nenin 11, të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe me nenin 52, pika a,b,c të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, pasqyruar në tabelat emërtuar: **“Leje Përdorimi te Miratuara dhe Mungesa e Aplikimit të Gjobave për Vonesat Viti 2015 Tabela nr.2.1”**, **“Leje Përdorimi te Miratuara dhe Mungesa e Aplikimit të Gjobave për Vonesat Viti 2016 Tabela nr.2.2”** sipër (Trajtuar hollësisht ne faqet 256-259 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).

25.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë (Autoriteti Zhvillimit Territorit), Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në bashkëpunim me IMTV të marrin masat e duhura administrativo–ligjore, të procedojnë për aplikimin e gjobave dhe arkëtimin e vlerës së **dëmit ekonomik nga 450,000-4,500,000 lekë** që iu përkasin të **10 lejeve përdorimi** lëshuar **në vitin 2015** tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 6 muaj deri në 12 vjet, në kundërshtim me afatet me **dëmin ekonomik në vlerën nga 350,000-3,500,000 lekë**, duke mos aplikuar vlerën e gjobës, ndërsa në **vitin 2016** për **2 leje përdorimi** tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 3 vjet deri 5 vjet, në kundërshtim me afatet që kanë shkaktuar **dëmit ekonomik në vlerën nga 100,000-1,000,000 lekë**, duke mos aplikuar vlerën e gjobës.

Menjëherë

26.Gjetje nga auditimi: 2.a.2. Nga mungesa e të dhënave të monitorimit për 3 vitet 2014, 2015 dhe 2016 të këtyre 13 kontratave qiradhënies në zonën Golem është krijuar dem i ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën prej **5,013,645 lekë qera e papaguar dhe kamatëvonesa nga e cila 4,838,310 lekë qira dhe 175,335 lekë Kamatë vonesa në kundërshtim me nenin 5 të kontratës** llogaritur sipas tabelës emërtuar **“Detyrimet e pa shlyera të vlerës qirasë dhe Kamatëvonesat për kontratat e lidhura për dhënie në përdorim te sipërfaqeve pyjore Zona Golem neni 5 i Kontratës për vitet 2014, 2015 dhe 2016”**, në kundërshtim me VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për Përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”lidhja 2, pikal **“Tarifat për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik”**(Trajtuar në faqet 263-267 të Raportit Përfundimtar te Auditimit).

26.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat e duhura administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 5,013,645 lekë qera e papaguar dhe kamatëvonesa nga e cila**

4,838,310 lekë qira dhe 175,335 lekë Kamatë vonesa në kundërshtim me nenin 5 të kontratës llogaritur sipas tabelës emërtuar “**Detyrimet e pa shlyera të vlerës qirasë dhe Kamatëvonesat për kontratat e lidhura për dhënie në përdorim të sipërfaqeve pyjore Zona Golem neni 5 i Kontratës për vitet 2014,2015 dhe 2016**” me VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për Përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave” lidhja 2, pikal “Tarifat për dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik”.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kavajë, sektori i Pyjeve në marrjen në dorëzim të fondit pyjor nuk ka kryer inspektim dhe nuk ka ushtruar kontroll të territorit e as menaxhimin të fondit pyjor të **Pyllit Mbrojtës ngastra 10a “Mali Robit” Kavajë** me anë të inspektoratit pyjor Bashkiak, mosveprim ky në kundërshtim me pikën 20 të Urdhrit të Ministrit Mjedisit nr 7531, datë 28.12.2015 “Mbi marrjen e masave për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave” dhe në kundërshtim me ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, që ka sjellë si pasojë zaptime me ndërtime të paligjshme pa titull pronësie në **32 raste** në sipërfaqen prej **3,999 m²** pyll e tokë pyjore bujqësore me dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën **9,597,600 lekë** si vlerë qeraje e munguar dhe pa arkëtuar nga e cila **13 raste të sipërfaqes prej 1535 m²** me ndërtesa brenda fondit pyjor prej **6,2 ha** në pronësi të Bashkisë duke shkaktuar dëmit ekonomik dhe e ardhur e munguar në vlerën **3,684 mijë lekë** si vlerë qira e munguar pa arkëtuar nga zaptimi i sipërfaqes kthyer në truall me ndërtime pa titull pronësie dhe **19 raste të sipërfaqes prej 2464 m²** me ndërtesa Brenda fondit toke pyjore sipërfaqe bujqësore në pronësi të Bashkisë duke shkaktuar dëmit ekonomik dhe e ardhur e munguar në vlerën **5,913,6 mijë lekë**, pasqyruar në tabelën emërtuar “Zaptime me ndërtime të Paligjshme të Pyllit Mbrojtës Ngastra 10a “Mali Robit” (Trajtuar hollësisht në faqet 267-269 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë, me strukturat përkatëse sektori i Pyjeve, polici pyjore IMTV, Polici Bashkiakë të marrin masa për lirimin dhe kthimin e sipërfaqeve pyjore të zaptuar me ndërtime paleje pa tituj pronësie në **32 raste** në sipërfaqen prej **3,999 m²** brenda fondit pyjor prej **6,2 ha** në pronësi të Bashkisë, marrjen nën administrim dhe menaxhim të fondit pyjor të **Pyllit Mbrojtës ngastra 10a “Mali Robit” Kavajë, të kërkojë nëpërmjet procedurave ligjore arkëtimin e vlerës 9,597,600 lekë** dëm ekonomik si vlerë qeraje e munguar dhe pa arkëtuar për **13 raste të sipërfaqes prej 1535 m²** me ndërtesa brenda fondit pyjor në vlerën **3,684 mijë lekë** dhe **19 raste të sipërfaqes prej 2464 m²** me ndërtesa Brenda fondit toke pyjore sipërfaqe bujqësore në pronësi të Bashkisë duke shkaktuar dëmit ekonomik dhe e ardhur e munguar në vlerën **5,913,6 mijë lekë**, pasqyruar në tabelën emërtuar “Zaptime me ndërtime të Paligjshme të Pyllit Mbrojtës Ngastra 10a “Mali Robit”.

Menjëherë

28.Gjetje: Nuk janë lidhur monitoruar 10 kontrata vjetore për qira banese, ndërsa ato shfrytëzohen dhe është krijuar dëmi ekonomik dhe të **ardhura të munguara nga qeraja për banesa në vlerën 164,120 lekë** për vitet 2015 dhe 2016 për mos lidhje të kontratave nga të cilat 4 kontrata me vlerën 62,280 lekë në v. 2015 dhe nuk janë lidhur arkëtuar e monitoruar kontrata me vlerën 101,840 lekë për vitin 2016, në kundërshtim me Kreun IV “Monitorimi i kontratave” mungesa e dokumenteve përkatëse sipas pikave 1,2 germa,”b”,”c”, deri germa “dh” të VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore” ndryshuar me VKM nr.992, datë 9.12.2015 **pasqyruar në tabelën emërtuar “1. Tabela e Dhënies me Qira Vjetore Banesa Strehimi në Ndërtesat ish- Fabrika Letrës, e ish- depo grumbullimi viti 2015 dhe 2016** (Trajtuar hollësisht në faqet 269-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat administrative ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 164,120 lekë për vitet 2015 dhe 2016 për moslidhje të 4 kontratave me vlerën 62,280 lekë në v. 2015 dhe 101,840 lekë për vitin 2016 nga mos arkëtimi e mungesa e monitorimit 10 kontratave vjetore për qira banese.

Menjëherë

29. Gjetje: Në dhënien me qira të trojeve për veprimtari artizanati e lavazh dhe sipërfaqeve në bregdet për instalim lojëra ne plazh është krijuar dëmi ekonomik dhe *të ardhura të munguara në vlerën 575,200 lekë ndarë 455,200 lekë në kontratat e trojeve për përpunim mermeri e lavazh nga kontratat e parregullta dhe mungesa e monitorimit, si dhe 120,000 lekë për 3 kontrata me afat 1 muaj, pra 2 muaj me pak se sezoni i plazhit për aktivitet vendosje lojërash*, pasqyruar në tabelën emërtuar “2. Tabela e Dhënies me Qira Mujore apo Vjetore Sipërfaqe trojesh Ambientesh ose Ndërtesa viti 2015 dhe 2016” (*Trajtuar hollësisht në faqet 269-276 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat administrative ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 575,200 lekë ndarë 455,200 lekë në kontratat e trojeve me subjektet për aktivitet përpunim mermeri e lavazh nga kontratat e parregullta dhe mungesa e monitorimit dhe 120 000 lekë për 3 kontrata me afat 1 muaj, pra me afat 2 muaj me pak se sezoni i plazhit me aktivitet vendosje lojërash pasqyruar në tabelën emërtuar “2. Tabela e Dhënies me Qira Mujore apo Vjetore Sipërfaqe trojesh Ambientesh ose Ndërtesa viti 2015 dhe 2016”.

Menjëherë

29.2 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat administrative ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 307,376 lekë (180 000 lekë nga mos pagim kësti I-rë kontrata nr.107, datë 23.01.15, fatura nr. 2, a.-176,000 lekë (384,000-208,000) për ulje të sipërfaqjes nga 200 m² në 130 m² të pa dokumentuara me procesverbal pasqyruar tabelën emërtuar: ”Lidhja e kontratës plotësimi i detyrimeve, dhe monitorimi për objektin Pallati Kulturës “KAVALJON” per vitin 2014,2015,2016 Qiramarrësi P C”.

Menjëherë

30.Gjetje: Bashkia Kavajë lidhur me Gabinat Plazh Golem dhënien me qira e mos ndjekjen e monitorimin e marrëdhënies nuk ka vepruar për te kërkuar ne rruge ligjore ne bashkepunim me organet e rendit lirim e objektit dhe shlyerjen e detyrimit, por dhe nuk është ndjekur rruga ligjore ne zbatim te nenit 8, zgjidhja e kontratës,pika 2,4 dhe neni 9 ku shprehet zgjidhja ne rruge gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë: pra nuk ka kërkesë padi nga kjo Bashki për likuidimin e detyrimeve, prishjen e kontratës dhe lirim e objektit, për pasojë është krijuar dëmi ekonomik dhe te ardhurat e munguara ne vlerën totale 4,808,880 leke përkatësisht: vlera 19,440 leke për 3 kontrata ne vitin 2013, vlera 51,840 leke për 8 kontrata ne vitin 2014, vlera 2,368,800 leke për 25 kontrata te palidhura dhe qw janë përdorur ambientet pa shlyer detyrimin; ne vitin 2015, vlera 2,368,800 leke per 25 kontrata te palidhura dhe qe janë përdorur ambientet pa shlyer detyrimin ne vitin 2016, ne kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në kundërshtim me Kreun IV “Monitorimi i kontratave” mungesa e dokumenteve përkatëse sipas pikave 1,2 germat, ”b”, ”c”, deri germa “dh” të VKM nr.54, datë 5.2.2014 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurës e të Mënyrës së Dhënies me Qira, Enfiteozë apo Kontrata të Tjera të Pasurisë Shtetërore” ndryshuar me VKM nr.992, datë 9.12.2015 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sektorit publik,” pasqyruar ne tabelën e emërtuar: “Tabela e Kontratave të Lidhura, Monitorimi i Zbatimit dhe Likuidimi i Detyrimeve për Objektin “GABINA PLAZHI GOLEM“ viti 2013,2014,2015 dhe viti 2016” (*Trajtuar hollësisht ne faqet të Raportit Përfundimtar 276-280 të Auditimit*).

30.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat administrativo ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **4,808,880 leke** përkatësisht: vlera 19,440 leke per 3 kontrata ne vitin 2013, vlera 51,840 leke per 8 kontrata ne vitin 2014, vlera 2,368,800 leke per 25 kontrata te palidhura dhe qe janë përdorur ambientet pa shlyer detyrimin; ne vitin 2015, vlera 2,368,800 leke për 25 kontrata te palidhura dhe qe janë përdorur ambientet pa shlyer detyrimin ne vitin 2016, pasqyruar ne tabelën e emërtuar: “Tabela e Kontratave të Lidhura, Monitorimi i Zbatimit dhe Likuidimi i Detyrimeve për Objektin “Gabina Plazhi Golem“ viti 2013,2014,2015 dhe viti 2016”.

Menjëherë

31. Gjetje: Për mungesë të monitorimit së kontratave të 13 dyqaneve për shkak të rikonstruksionit, **për periudhën deri në vitin 01.01.2015 me dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën 40,680 lekë dhe për** vonesa e mosfillim të procedurave për publikim e dhënie me qira dhe lidhjen e kontratave të 13 dyqaneve, që ka sjellë si pasojë te ardhura te munguara në vlerën **157,590 lekë** nga e cila 52,530 leke për 2 muaj të vitit 2016 dhe 105,060 lekë për 4 muaj të vitit 2017, llogaritur me vlerën e kontratave të mëparshme gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar hollësisht ne faqet 276-280 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

31. 1 Rekomandim: Bashkia Kavajë të marrë masat administrativo ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën **157,590 lekë** nga e cila 52,530 leke për 2 muaj të vitit 2016 dhe 105,060 lekë për 4 muaj të vitit 2017 **për** vonesa e mosfillim të procedurave për publikim e dhënie me qira dhe lidhjen e kontratave të 13 dyqaneve.

Menjëherë

32.Gjetje: Ish-Komuna Synej për periudhën 10 vjeçare 2008-2017 nga mungesa e monitorimit dhe zbatimit të kontratës **nr, datë 29.04.2008**, lidhur me subjektin E, shpk Tiranë, është krijuar dëmi ekonomik prej **1,504,940 lekë** prej të cilës **830,000 lekë qira e papaguar** (përkatësisht në vitet v.2010, për 410,000 lekë, në 2011nga 420,000 lekë, pasi mungon dokumentacioni) dhe **674,940 lekë kamatëvonesa të pallogaritura dhe të pa arkëtuara** për shlyerje të vonuara përkatësisht: 44,940 lekë në vitin 2008 vonesa prej 107 ditë dhe 630,000 lekë kamatëvonesa për vonesa nga 365 ditë në vitin 2010, 2011,2012,2013 , 2015 dhe 2016 përkatësisht nga 105,000 lekë, për vonesa mbi 1 vit (llogaritur me 0,001% dhe jo më shumë se 25% të vlerës së papaguar) (*Trajtuar hollësisht ne faqet 282-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

32.1 Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Synej të marrë masa në rrugë administrativo-ligjore të arkëtojë vlerën **1,504,940 lekë** prej të cilës **830,000 lekë qira e papaguar** (përkatësisht në vitet v.2010, për 410,000 lekë,në 2011 nga 420,000 lekë, pasi mungon dokumentacioni) dhe **674,940 lekë kamatëvonesa të pallogaritura dhe të pa arkëtuara** për shlyerje të vonuara përkatësisht: 44,940 lekë në vitin 2008 vonesa prej 107 ditë dhe 630,000 lekë kamatvonesa për vonesa nga 365 ditë në vitin 2010, 2011, 2012, 2013, 2015 dhe 2016 përkatësisht nga 105,000 lekë, për vonesa mbi 1 vit (llogaritur me 0,001% dhe jo më shumë se 25% të vlerës së papaguar) dëm ekonomik i rrjedhur nga mungesa e monitorimit dhe **zbatimin e kontratës për periudhën 10 vjeçare 2008-2017, plotësimi i detyrimeve.**

Menjëherë

33. Gjetje: Ish-Komuana Helmas, aktualisht NJA Bashkia Kavajë, prej viteve 2012-2013 ka lidhur 5 kontrata qeradhënie toke bujqësore për 99 vjet, për kultivim drurësh shumë vjecar ullishte, **me vlerë vjetore qiraje 72,860 lekë, për të cilat nga mungesa e monitorimit dhe zbatimit të kontratave për 5 vitet 2012-2016 është krijuar dëmi ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën 88,110 lekë nga mos pagesa në kohë e qirasë, në kundërshtim me bazën ligjore të mësipërme me Kodin Civil “Kontrata e Qiradhënies Pasuri e Paluajtshme “Tokë bujqësore”, ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Kontratat e Qiradhënies Tokës Bujqësore**

menaxhimi monitorimi i zbatimit dhe likuidimi i detyrimeve v.2012-2016 Ish-Komuna Helmas Kavajë”(Trajtuar hollësisht ne faqet 288-293 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1 Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Helmas të marrë masa për arkëtimin e **vlerës 88,110 lekë**, nga mos pagesa në kohë e qirasë, për periudhën **për 5 vite 2012-2016** për 5 kontrata qiradhënie toke bujqësore, për sipërfaqen 78625 m² ose 7,8625 ha me afat deri 99 vjet për kultivim drurësh shumë vjeçar ullishte, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Kontratat e Qiradhënies Tokës Bujqësore menaxhimi monitorimi i zbatimit dhe likuidimi i detyrimeve v.2012-2016 Ish-Komuna Helmas Kavajë”.

Menjëherë

34.Gjetje: Ish-Komuna Golem, aktualisht NJA, për vitin 2015 për 84 subjekte që kanë shfrytëzuar rërën në sipërfaqen 51 753 m² gjatë sezonit, janë lidhur vetem 8 kontrata me sipërfaqe 8372 m² rërë me vlerën 2,093,000 lekë, (nga të cilat 3 kontrata ekzistuese me sipërfaqe **4 360 m²**, me vlerë **1,090,000 lekë** dhe **5 kontrata** të reja me sipërfaqe **4 012 m²**, me vlerë **1,003,000 lekë**), janë njoftuar me shkresat nr.2543/1-88, datë 16.7 deri 22.7.2015 për lidhje kontrate 29 subjekte me sipërfaqe 19 145 m² me vlerë 4, 786,250 lekë, të cilët kanë pas kontratë nga v.2014 dhe janë njoftuar për lidhje kontrate të reja 47 subjekte me sipërfaqe **24236 m²** me vlerë **6, 059,000 lekë**. Pra për vitin 2015 për **84 subjekte** që kanë shfrytëzuar rërën në sipërfaqen **51753 m²** në vlerën **12,938,250 lekë kane paguar 9 subjekte në sipërfaqen 8012 m²** lerën **prej 2,003,000 lekë** dhe nuk kanë paguar e nuk kanë lidhur kontrata, megjithëse janë njoftuar dhe megjithëse kanë shfrytëzuar rërën **73 subjekte në sipërfaqen 44111 m²** në vlerën **prej 10,935,250 lekë që përbën dëm ekonomik për ish Komunën Golem tani Bashkinë Kavajë, në kundërshtim me** ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“ dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe në kundërshtim me nenin 4 “Të Drejtat dhe Detyrimet e Marrësit në Përdorim të Hapësirës Publike“ paragrafi dytë ku shprehet: “*Qiramarrësi është i detyruar që në momentin e lidhjes së kontratës të bëjë pagesën e detyrimit ne arkën e komunës ose në cdo bankë të nivelit të dytë sipas faturës për arkëtim pasqyruar në tabelën emërtuar: “3.Kontrata rëre të lidhura nga v.14, të pa lidhura dhe njoftuara por që kanë shfrytëzuar sipërfaqet ranore Komuna Golem viti 2015 Tabela nr.3“* (Trajtuar hollësisht ne faqet 293-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1 Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Golem të marrë masa duke ndjekur hapat e duhura ligjorë për arkëtimin e vlerës dëmit kontratave të shfrytëzimit të rërës ne v.2015 për **73 subjekte në sipërfaqen 44111 m²** vlerën **prej 10,935,250 lekë**, pasqyruar në tabelën emertuar: “**3.Kontrata rëre të lidhura nga v.14, të pa lidhura dhe njoftuara por që kanë shfrytëzuar Komuna Golem viti 2015 Tabela nr.3“**.”

Menjëherë

35 Gjetje: Ish-Komuna Golem, aktualisht NJA nuk ka ndjekur e kërkuar plotësimin e detyrimeve, nuk ka monitoruar e rinovuar 3 kontratat me **Operatorët X, C dhe A sh.a.** me dëmin ekonomik dhe të ardhura të munguara në vlerën prej **776,950 lekë** për 4 vjet 2013-2016 (X -510,000 lekë, C -172,450 lekë dhe A sh.a; -94,500 lekë), në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, në kundërshtim pika 10.1 e kontratës ku shprehet “.....moskryerja e pagesës brenda 2 muajsh nga data e përcaktuar neni 4, apo neni 13.2

për kontratën me C, për mos rinovim në kohë apo ndërprerje të kontratave përdorim të pasaktë të tarifave të nivelit të qerasë me të ulta për 3 operatorët me pasojë dëmin ekonomik **dhe të ardhurat e munguara në vlerën 1,278,000 lekë** për vitët 2015-2016, (llogaritur 50 m²x100/lekë/m²/muaj x 24 muaj =1,800,000-521,500 lekë), pasqyruar në tabelën emërtuar. “Kontratat me Operatorët e Telefonisë dhe likuidimet, gjendja dhe rinovimi i tyre lidhur nga

ish-Komuna Golem” (Trajtuar hollësisht ne faqet 293-298 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

35.1 Rekomandim: Bashkia Kavaje, NJA Golem të marrë masa të arkëtojnë në vlerën prej **776,950 lekë** qira e papaguar për 4 vjet 2013-2016 të rishqyrtojë, saktësojë, eliminojë mangësitë në dokumentacione, pasaktësitë e parregullsitë në përmbajtje, si dhe të përditësojë me aktet e reja nënligjore dhe të rishkruajë 3 kontratat me **Operatorët X, C dhe A sh.a**, sipas emërtuar: “Kontratat me Operatorët e Telefonisë dhe likuidimet, gjendja dhe rinovimi i tyre lidhur nga ish-Komuna Golem”.

35.2 Rekomandim: Bashkia Kavajë, NJA Golem të marrë masa duke ndjekur hapat e duhura ligjorë për arkëtimin e vlerës prej **1,278,000 lekë** për vitet 2015-2016, (llogaritur $50 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ muaj} \times 24 \text{ muaj} = 1,200,000 - 521,500 \text{ lekë}$), rrjedhur nga mos rinovimi në kohë apo ndërprerje të kontratave dhe përdorim të pasaktë të tarifave të nivelit të qerasë me të ulta për 3 operatorët, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Kontratat me Operatorët e Telefonisë dhe likuidimet, gjendja dhe rinovimi i tyre lidhur nga ish-Komuna Golem”.

Menjëherë

36. Gjetje: IMTV Kavajë për vitin 2015-2016 performancë të pamjaftueshme të punës shprehur me numrin e kufizuar të kontrolleve dhe numrit të kufizuar të vendosjes së gjobave, ndjekjes dhe ecurisë së proceseve gjyqësore për arkëtimin e gjithsejtë **24 gjoba** me vlerë **15,237,372 lekë** ndarë: **6 gjoba me vlerë 1,250,000 lekë** nga rekomandimet e KLSH të cilat janë ne proces gjyqësor (Apel & ShI) dhe **18 gjoba me vlerë 13,987,732 lekë** që i përkasin vitit 2016 prej të cilave janë arkëtuar 12 gjoba me vlerën **9,987,732 lekë**, janë në përmbarrim **3 gjoba me vlerën 2,000,000 lekë** dhe **3 gjoba me vlerën 2,000,000 lekë** ne proces gjyqësor, që tregon nivel të ulët performance, vërteton mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit me Urbanistikën, lidhur me ndjekjen e zbatimit të ligjit të urbanistikës për lejet e dhëna prej vitit 2013,2014,2015 dhe 2016 dhe për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve gjatë ushtrimit të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”,neni 16 dhe me ligjin nr.10279, datë 20.05,2010 “Për Kundravajtjet Administrative” neni 9 dhe 22 “Ekzekutimi i kundravajtjeve administrative”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Shkaqet e vendosjes me Vendimet e Gjobave të IVMT Bashkia Kavajë dhe ecuria e vjeljes v.2015-2016 Tabela nr.2**”, bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht ne faqet 302-306 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

36.1 Rekomandim: IMTV Bashkia Kavajë të marrë masa për rritjen e numrit të kontrolleve të territorit, ndjekjen e ecurisë së proceseve gjyqësore për arkëtimin e **12 gjobave me vlerën 5,250,000 lekë prej të cilave; 6 gjoba me vlerë 1,250,000 lekë** nga rekomandimet e KLSH, **3 gjoba me vlerën 2,000,000 lekë** në përmbarrim dhe **3 gjoba me vlerën 2,000,000 lekë** ne proces gjyqësor”, pasqyruar në tabelën emërtuar: “**Shkaqet e vendosjes me Vendimet e Gjobave të IVMT Bashkia Kavajë dhe ecuria e vjeljes v.2015-2016 Tabela nr.2**”, bashkëlidhur.

Menjëherë

C. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE

C.I. Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në Bashkinë Kavajë, u konstatua se 4 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2, “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53, “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK)

dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në **vlerën totale të fondit limit 800,414,976 lekë, duke favorizuar operatorët ekonomikë, në shumën 62,744,447 lekë, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomikitet i fondeve, të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kritere të paplota e konkretisht sipas tenderave më poshtë:**

1. Në tenderin me objekt **“Rehabilitimi i Prroit Leshniqe”**, me fond limit 375,000,000 lekë”, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e operatorit ekonomik “Z” shpk, me vlerë 350,247,320 lekë, *vlera më e ulët*, për arsye se: a) *“ky subjekt ka detyrime fiskale të pashlyera”*. Por për të cilën kjo shoqëri ka paraqitur dokumentacion ku vërteton procesin gjyqësor ndaj këtij detyrimi. b) *“furnitorët për pemë dekorative dhe pajisje elektrike, certifikatat ISO 9001:2008 nuk i kanë të përkthyer në gjuhën shqipe”*, mangësi e cila lehtësisht mund të konsiderohej devijim i vogël, për asye se nuk prek dhe nuk ndikon në përmasat dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi. Për më tepër, KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE “X” shpk, me vlerë 371,672,160 lek, *me vlerë më të lartë*, dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të (DST). **Si rrjedhojë, i është shkaktuar buxhetit të shtetit mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 21,424,840 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE padrejtësisht të kualifikuar dhe shpallur fitues “X” shpk minus (-) ofertën e “Z” shpk (371,672,160- 350,247,320)= 21,424,840 lekë (Trajtuar hollësisht në faqet 132-139 të Raporti Përfundimtar i Auditimit).

2. Në tenderin me objekt **“Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Rilindja”**, lagjia nr.1 Kavajë”, zhvilluar në 2016, kanë paraqitur oferta ekonomike tre operatorë ekonomik. Pas tërheqjes nga procedura të dy *operatorëve ekonomik*, dy ditë përpara shpalljes së fituesit, konkretisht të BOE "A"shpk&"C"shpk &"E" me vlerë të ofertës 69,100,888 lekë dhe BOE"A"shpk & "Y" shpk me vlerë të ofertës 72,557,688 lekë, *të cilët nga vlerësimi në sistem i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në DST*, KVO ka shpallur fitues operatorin e ngelur në garë, BOE “G” shpk dhe “P” shpk, me vlerën më të lartë nga tre ofertat ekonomike të paraqitura, prej 82,385,779 lekë pa TVSH. BOE “G” shpk dhe “R” shpk nuk plotëson shtatë kritere të veçanta të kualifikimit të vendosura në DST, duke u shpallur padrejtësisht fitues. Si pasojë, tenderi duhet të ishte anuluar dhe mos kryerja e këtij veprimi, ka shkaktuar **mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 13,284,891 lekë**, si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës më të ulët 69,100,888 lekë, ofruar nga BOE "AB"shpk&"C"shpk &"E" shpk, i cili pavarësisht tërheqjes 2 ditë përpara shpalljes së fituesit ka qenë një ofertë e vlerësuar në sistem nga KVO se i ka plotësuar të gjitha kriteret e DST (Trajtuar hollësisht në faqet 185-191 të Raporti Përfundimtar i Auditimit).

3. Në tenderin me objekt **“Shërbimi pastrimit të qytetit Kavajë”** zhvilluar në datën 15.02.2016, me fond limit 147,519,416 lekë pa TVSH, KVO dhe titullari i AK midis dy operatorëve ekonomik: “E” shpk i cili ka vetëm një mangësi, mungesën e kontrollit teknik të një mjeti, por vlerën e ofertës ekonomike më të ulët (127,500,526 lekë) dhe, OE “X” shpk, i cili për dy mjete nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, nuk vërteton se ka kryer kontrollin teknik dhe siguracionin e mjeteve, nuk vërteton se ka paguar detyrimet për taksat vendore në shtetin e Kosovës (nuk ka paraqitur

deklaratë se ky formular nuk aplikohet në shtetin e Kosovës), si dhe ka ofertën ekonomike më të lartë (139,746,161 lekë), KVO ka zgjedhur fitues OE “X” shpk, me më shumë mangësi dhe ofertë më të lartë, duke shkaktuar **mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 12,245,635 lekë**, si diferencë midis vlerave të dy ofertave. Për arsye se asnjë operatorë nuk i plotëson kriteret tenderi duhej të anullohej, duke bërë që KVO dhe titullari i AK të veprojnë me dy standarde (Trajtuar më hollësisht në faqet 162-225 të Raportit).

4. Në tenderin me objekt “**Skema ujitëse Peqin-Kavajë, sekondarët Kavajë (rehabilitim i pjesshëm)**”, zhvilluar në datën 13.04.2016, KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, midis dy operatorve ekonomik, të cilët janë në të njëjtat kushte, plotësojnë kriteret e vendosura në DST, kanë shpallur fitues operatorin ekonomik “S”& “N” Shpk, me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike 42,486,369 lekë, duke shkaktuar **mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 5,737,739 lekë**, si diferencë midis vlerës së ofertës fituese dhe vlerës së ofertës ekonomike të skualifikuar padrejtësisht 36,748,630 lekë, paraqitur nga BOE “B & Sh” shpk (Trajtuar hollësisht në faqet 192-199 të Raporti Përfundimtar i Auditimit).

5. Në tenderin me objekt “**Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.2 tek ish rezervat e shtetit**”, me fond limit 19,547,464 lekë” zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e “K” shpk, me vlerë të ofertës 14,680,378 lekë, me vlerë më të ulët, me pretendimin se “Nuk ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore bazuar në vërtetimin Nr. 1063 Prot., datë, 16.04.2015, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe”, por nga auditimi rezultoi se: ky pretendim i KVO nuk qëndron pasi në lidhje me këto detyrime të papaguara shoqëria “K” shpk ka bërë marrëveshje me Drejtorinë Rajonale Tatimore Lezhe me Nr. 1810 Prot., datë 17.04.2015 për shlyerjen me këste të këtij detyrimi të papaguar. Çka i ka shkaktuar buxhetit të shtetit **2,563,290 lekë mos përdorim me efektivitet të fondeve**. Për më tepër, KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE “Z” shpk, me vlerë më të lartë, dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST (Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Në tenderin me objekt “**Rikonstruksioni i rrugës fragment i shëtitores nr.1 (nga teqja-rruga dalëse) faza III**”, me fond limit 118,341,805 lekë” zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e BOE “X” shpk & Y shpk”, me vlerë më të ulët, për arsye se: a) mungon inventari i mjeteve dhe (b) furnitori me materiale elektrike nuk ka paraqitur certifikatën e origjinës se materialeve të kërkuara). Mangësi të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla duke krahasuar leverdinë ekonomike të këtij ofertuesi, pasi nuk prek dhe nuk ndikon në përmasat dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi, në kundërshtitë me nenin 53 pika 4 të LPP. Çka i ka shkaktuar buxhetit të shtetit **4,644,738 lekë mos përdorim me efektivitet të fondeve**. Për më tepër, KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE “Z” shpk, me vlerë më të lartë, dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST (Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Në tenderin me objekt “**Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të varrezave**”, me fond limit 9,525,025 lekë” zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO ka s’kualifikuar padrejtësisht nga gara ofertën e “E shpk, me vlerë më të ulët, për arsye se sipas KVO: a) vërtetimi energjisë elektrike nuk ishte i rregullt, dhe b) nuk ka paraqitur ekstraktin e QKR, por nga auditimi rezultuan se kjo shoqëri i ka paraqitur këto dokumente të rregullta dhe sipas afatit kohor të kërkuar. Çka i ka shkaktuar buxhetit të shtetit **2,843,314 lekë mos përdorim me efektivitet të fondeve**. Për më tepër, KVO ka vepruar me dy standarde pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e OE “N” shpk, me vlerë më të lartë, dhe me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST (Trajtuar në faqet 110-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kavajë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative të pamatshme.

Në vijimësi

C.II.Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2015-2016, në 11 tendera në vlerën totale të fondit limit **21,138,865 lekë**, të gjithë me kohëzgjatje 3 mujore, janë shkelur rregullat e prokurimit publik lidhur me përzgjedhjen e gabuar të procedurës që ka sjellë si pasojë përdorimin e fondeve publike të mësipërm pa efikasitet dhe efektivitet përkatësisht për tenderat si me poshtë :

- 2 tendera me objekt “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë” (1 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.6, datë 24.03.2015, me fond limit 3,723,935 lekë; 2 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.2, datë 08.01.2016 me fond limit 3,619,406 lekë).

- 3 tendera me objekt furnizimi me ushqime për kopshte e çerdhe (1 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.1, datë 05.01.2015 me fond limit 1,600,604 lekë; 2 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.5, datë 26.01.2016, me fond limit 1,821,508 lekë; 3 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.5/1, datë 29.04.2016, me fond limit 1,197,658 lekë).

- 2 tendera blerje karburant, (1 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.4, datë 25.01.2016, me fond limit 785,000 lekë; 2 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.4/1, datë 10.05.2016, me fond limit 3,010,425 lekë).

- 4 tendera me objekt shërbimi i ruajtjes me roje fizike, (1 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.3, datë 05.01.2015, me fond limit 1,379,065 lekë; 2 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.3/1, datë 06.04.2015, me fond limit 1,379,065 lekë; 3 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.1, datë 08.01.2016, me fond limit 1,362,805 lekë; 4 tenderi zhvilluar me urdhër prokurimi nr.1, datë 08.04.2016, me fond limit 1,259,394 lekë).

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. E.R, njësia e prokurimit z.E.A, zj.M.D. dhe zj.Xh M (në 7 tendera), A. H (në 4 tendera, vlera **7,910,202 lekë**), është përzgjedhur lloji i procedurës së prokurimit “*Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, duke mos u plotësuar asnjë rrethanë ligjore që të justifikojë zgjedhjen e kësaj procedure, e cila është jo konkurruese dhe jo e zhvilluar në sistemin elektronik të APP.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 33 “*Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit*”, të ligjit 9643 “Për prokurimi publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenin 36 “*Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu në këto procedura edhe pse Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të ftoj për pjesëmarrje në tender tre operatorë ekonomik, nuk vërtetohet me dokumentacion se ka realizuar këtë kërkesë ligjore, duke mos siguruar transparencë në përzgjedhjen e fituesit. Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar konkurrencë dhe barazi në tender, veprim në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 33 të ligjit 9643 “Për prokurimi publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar, pikën 4 të nenit nr. 36, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në tre prej tenderave të mësipërm, në vlerën totale **3,758 mijë lekë** edhe pse ka dalë urdhri i prokurimit nga titullari, NJP nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi. Lidhja e kontratës është bërë me operatorin e mëparshëm, si vazhdim i kontratës 3 mujore ekzistuese, konceptuar nga z. E.A. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve dhe nënshkruar nga Titullari z. E. R.

b.Përeç sa më sipër, në 3 raste nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Kavajë, ish Titullari z. E. R është lidhur kontratë me afat 3 mujor, me operatorët ekonomik, pa u zhvilluar më parë procedurë prokurimi (2 kontrata për kryerjen e shërbimit të pastrimit të qytetit

përkatësisht: Kontrata nr.435/4, datë 29.6.2015 me vlerë 3,718,851 lekë dhe Kontrata nr. 435/5, datë 28.9.2015 me vlerë 3,591,329 lekë dhe 1 kontratë nr.17/5, datë 7.4.2015 me vlerë 1,589,227 lekë për furnizimin me ushqime për kopsht e çerdhe); pra në vlerën totale **8,899,407 lekë**, veprim në kundërshtim me nenin nr.1, të ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin nr.70 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në këtë mënyrë përcaktimi i kontraktit është bërë

apriori nga titullari z. E.R, si nënshkruer i kontratës dhe z. E. A, konceptues i kontratës, me detyre përgjegjës i sektorit të prokurimeve (*Trajtuar në faqet 162-225 të Raportit*).

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kavajë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 11 tendera (të gjithë me kohëzgjatje 3 mujore, 2 tendera me objekt shërbimi i pastrimit të qytetit, 3 tendera me objekt furnizimi me ushqime për kopshte e çerdhe, 2 tendera blerje karburant, 4 tendera me objekt shërbimi i ruajtjes me roje fizike), me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale të fondit limit **21,138,865 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Në vijimësi

D. MASA DISPLINORE:

D/I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Kavajë të bëjë vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për 23 drejtuesit dhe punonjësit e mëposhtëm:**

a-“Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “ç” e nenit 58. për 5 punonjësit:

1. znj. A. K, me detyre Drejtor i Burimeve Ekonomike

Për shkeljet e mëposhtme:

Për moszbatim të rekomandimeve në kundërshtim me ligjin nr.154/2014, shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e mosrealizim të buxhetit ligji nr. 9936, për shkeljet e trajtuara në mos administrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare, për shkeljet e trajtuara në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të vlera materiale inventar ekonomik faqet 65, 87-110 të Raportit përfundimtar të Auditimit.

2. zj. M. P, me Detyrë Drejtore Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse,

Për shkeljet e mëposhtme:

Për moszbatim të rekomandimeve ligji nr.154/2014, shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e masrealizim të buxhetit ligji 9936, për shkeljet e trajtuara në administrimin dhe realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksa e tarifa të miratuara me paketën fiskale, për në mosadministrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare për shkeljet në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të vlera materiale inventar ekonomik, dhe keqadministrim e monitorim të kontratave të aseteve sipas faqeve 65,77,87-110,281,284, 297,300 të Raportit përfundimtar të Auditimit.

3. z. Th. D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë në administrimin dhe menaxhimin e gjendjes debitore nga taksa e tarifa vendore, për shkeljet e trajtuara në administrimin dhe realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksa e tarifa të miratuara me paketën fiskale, për moszbatim të rekomandimeve të ligji 154/2014, shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e masrealizim të buxhetit ligji 9936 faqe fq.65, 77, 247-265 të Raportit përfundimtar.

4. z. Th.C, me detyrë ish-N/Kryetar, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve,

për shkeljet si më poshtë vijon:

-Nuk ka kryer detyrën për mbikëqyrjen e punës së tre supervizoreve, për tenderat e zhvilluar për pastrimin e qytetit Kavajë, NJA Golem dhe Njësive Administrative Synej, Helmas dhe Luz i Vogël. Në këto tendera nuk ka kryer inspektime për numrin e punëtorëve që janë angazhuar nga sipërmarrësi për realizimin e zërit “fshirje me fshesë dore, nuk ka kryer inspektimin e makinerive. Këto veprime janë në kundërshtim me detyrën e tij funksionale dhe nenin 11 të ligjit 10296 për MFK, veprim i cili ka sjellë efekte negative financiare për buxhetin e Bashkisë Kavajë; për shkeljet e trajtuara në mosadministrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare, për shkeljet e trajtuara në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të vlera materiale inventar ekonomik, dhe për mosveprim VKM nr. 510, date 10.06.2015, dhe nuk ka vepruar për zbatimin e tij shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e masrealizim të buxhetit ligji nr. 9936 faqe 77, 87-110, 289,293 dhe 302 të Raportit përfundimtar,

5. Z.E.A, me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit (NJP) në cilësinë e anëtarit të NJHDT, Për shkeljet e mëposhtme:

Shkeljet në 11 procedura prokurimi, me objekt:1.“Rehabilitimi i Prroit Leshniqe”,2. “Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.1 tek ish rezervat e shtetit”,3. “Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.2 tek ish rezervat e shtetit”,4. “Pastrim kanale kulluese Synej, Rrakull, Karpen dhe Qerret”,5. “Rehabilitimi i banesave në bashkpronësi”,6. “Rikonstruksioni i rrugës fragment i shtetores nr.1 (nga teqja-rruga dalëse) faza III”7. “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të varrezave”,8. “Rikonstruksioni i rrugëve “Et’hem Vogli, Ibrahim Xhafa dhe rrugës së Komunës (Degezim i rrugës Sufajve)”,9. “Instalimi i sistemit ngrohje ftohje në godinen e bashkisë Kavajë”,10. “Furnizimi me ushqime për kopshte, çerdhe dhe konvikte” 11. “Furnizimi me materiale elektrike për ndricim rrugor”, “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Synej Helmas dhe Luz i Vogel”, “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë, “Rruga e daljes (zona industriale) rikualifikim i plote faza II”, “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Rilindja", lagjja nr.1 Kavajë”, “Skema ujitëse Peqin-Kavajë, sekondaret Kavajë, “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”, Për periudhën 2015-2016, në 11 tendera. (Trajtuar në faqet 110-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Masa “Ulje në detyrë” deri në “largim nga shërbimi civil”, për 4 punonjësit si më poshtë”:

Për 4 anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave Bashkia Kavajë.

1-Zj.F.K, me detyrë përgjegjëse e sektorit të zhvillimit të territorit, në cilësinë e anatarit të KVO; për shkeljet në 11 procedura prokurimi, (sipas ANEKSIT-A bashkëlidhur Vendimit)

2-A.M, me detyrë përgjegjës i sektorit të menaxhimit të kontratave, në cilësinë e anatarit të KVO, për shkeljet në 11 procedura prokurimi, (sipas ANEKSIT-A bashkëlidhur Vendimit)

3-Zj.J. Q, me detyrë përgjegjëse e kadastrës dhe menaxhimit të aseteve, në cilësinë e anatarit të KVO, për shkeljet në 8 procedura prokurimi, (sipas ANEKSIT-A bashkëlidhur Vendimit)

4-Z.M. H, me detyrë përgjegjës sektori në drejtorinë ekonomike, në cilësinë e anatarit të KVO, për shkeljet në 8 procedura prokurimi, (sipas ANEKSIT-A bashkëlidhur Vendimit)

Si dhe Për shkeljet e përbashkëta në 3 tendera si më poshtë vijon,

1. Në tenderin me objekt “Shërbimi pastrimit të qytetit Kavajë” zhvilluar në datën 15.02.2016, me fond limit 147,519,416 lekë pa TVSH, KVO midis dy operatorëve ekonomik: “X” shpk i cili ka vetëm një mangësi, mungesën e kontrollit teknik të një mjeti, por vlerën e ofertës ekonomike më të ulët (127,500,526 lekë) dhe, OE “Y” shpk, i cili për dy

mjete nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, nuk vërteton se ka kryer kontrollin teknik dhe siguracionin e mjeteve, nuk vërteton se ka paguar detyrimet për taksat vendore në shtetin e Kosovës (nuk ka paraqitur deklaratë se ky formular nuk aplikohet në shtetin e Kosovës,) si dhe ka ofertën ekonomike më të lartë (139,746,161 lekë), KVO ka zgjedhur fitues OE "A" shpk, me më shumë mangësi dhe ofertë më të lartë, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 12,245,635 lekë, si diferencë midis vlerave të dy ofertave. Për arsye se asnjë operatorë nuk i plotëson kriteret, tenderi duhej të anulohet. KVO dhe titullari i AK kanë vepruar me dy standarde, në kundërshtim me nenin 1, pika 2, germa b/d/dh, nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 24, pika (ç), "Anulimi i një procedure prokurimi" nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave" të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

2. Në tenderin me objekt "Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Rilindja", lagjia nr.1 Kavajë, zhvilluar datën 19.08.2016, kanë paraqitur oferta ekonomike tre operatorë ekonomik. Pas tërheqjes nga procedura të dy *operatorëve ekonomik*, dy ditë përpara shpalljes së fituesit, konkretisht të BOE "X"shpk&"Y"shpk &"Z" me vlerë të ofertës 69,100,888 lekë dhe BOE"A"shpk & "E " shpk me vlerë të ofertës 72,557,688 lekë, të cilët nga vlerësimi në sistem i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, KVO ka shpallur fitues operatorin e ngelur në garë, BOE "V shpk dhe "N" shpk, me vlerën më të lartë nga tre ofertat ekonomike të paraqitura, prej 82,385,779 lekë pa TVSH. BOE "X" shpk dhe "P" shpk nuk plotëson shtatë kriteret të veçanta të kualifikimit të vendosura në DST, duke u shpallur kështu fitues nga KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor në kundërshtim me nenin 1, pika 2 germa b/d/dh, nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes, neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", pika (ç), nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", nenin 58 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Tenderi duhet të ishte anuluar dhe mos kryerja e këtij veprimi, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 13,284,891 lekë, si diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës më të ulët 69,100,888 lekë, ofruar nga BOE ""X"shpk&"Y"shpk &"Z" " shpk, i cili pavarësisht tërheqjes 2 ditë përpara shpalljes së fituesit ka qenë një ofertë e vlerësuar në sistem nga KVO se i ka plotësuar të gjitha kriteret e DST.

3. Në tenderin me objekt "Skema ujtitëse Peqin-Kavajë, sekondarët Kavajë (rehabilitim i pjeshëm), zhvilluar në datën 13.04.2016, KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, midis dy operatorëve ekonomik, të cilët janë në të njëjtat kushte, plotësojnë kriteret e vendosura në DST, kanë shpallur fitues operatorin ekonomik "Y"& "Ni" Shpk, me vlerën më të lartë të ofertës ekonomike 42,486,369 lekë, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet të fondeve në vlerën 5,737,739 lekë, si diferencë midis vlerës së ofertës fituese dhe vlerës së ofertës ekonomike të skualifikuar padrejtësisht 36,748,630 lekë, paraqitur nga BOE "A & B" shpk. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika "b", "d", "dh", nenin 2, nenin 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar. (Gjerësisht trajtuar në procesverbal si dhe faqen 110-225 të Raportit Auditit)

"Vërejtje" deri në "Largim nga shërbimi civil", për 6 punonjës:

1. z.E. L, me detyrë specialist dhe Drejtor Drejtorisë Kulturës dhe Sporteve prej 30.1.2016 ,për moszbatim të rekomandimeve fq.65 te Raportit përfundimtar ligji 154/2014, shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e mosrealizim te buxhetit ligji 9936 faqe 77, të Raportit përfundimtar

2. znj.D.Q, me detyrë Drejtore Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave prej Gushtit 2015, për shkelje të procedurave të hartimit dhe nivele të ulta e mosrealizim te buxhetit ligji

nr 9936 trajtuar në faqe 77, 269 monitorimi i ecurisë lejeve ndërtimit dhe lejeve përdorimit, 281, 284 mos monitorimi i kontratave të aseteve troje ndertës etj, të Raportit përfundimtar, për shkeljet e trajtuara në mos administrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare.

3 znj. A.H, me detyrë specialiste ing. ndërtimi, specialiste, në cilësinë e anëtares së NJP, *Për shkeljet në tenderat me objekt “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”, në 4 tendera të zhvilluar me procedurën “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për periudhën 2015-2016, për shkeljet në 2 procedura prokurimi, me objekt: 1. “Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.2 tek ish rezervat e shtetit” 2. “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të varrezave”, monitorimi i ecurisë lejeve ndërtimit dhe lejeve përdorimit, inventarizim i dosjeve faqe 110-225 dhe 269 të Raportit përfundimtar*

4. znj. Xh.M, me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtares së NJP, *Për shkeljet në tenderin me objekt: “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Synej Helmas dhe Luz i Vogel”, “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, lagjja nr.1 Kavajë”, “Skema ujitëse Peqin-Kavajë, sekondaret Kavajë (rehabilitim i pjesshëm)”, “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”, - Për periudhën 2015-2016, në 7 tendera (të gjithë me kohëzgjatje 3 mujore, 2 tendera me objekt shërbimi i pastrimit të qytetit, 3 tendera me objekt furnizimi me ushqime për kopshte e çerdhe, 2 tendera blerje karburant, 4 tendera me objekt shërbimi i ruajtjes me roje fizike),*

Për shkeljet në 9 procedura prokurimi, me objekt: 1. “Rehabilitimi i Prroit Leshniqe”, 2. “Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr.1 tek ish rezervat e shtetit”, 3. “Pastrim kanale kulluese Synej, Rrakull, Karpen dhe Qerret”, 4. “Rehabilitimi i banesave në bashkpronësi”, 5. “Rikonstruksioni i rrugës fragment i shëtitores nr.1 (nga teqja-rruga dalëse) faza III”, 6. “Rikonstruksioni i rrugëve “Et’hem Vogli, Ibrahim Xhafa dhe rrugës së Komunës (Degezim i rrugës Sufajve)”, 7. “Instalimi i sistemit ngrohje ftohje në godinen e bashkisë Kavajë”, 8. “Furnizimi me ushqime për kopshte, çerdhe dhe konvikte”, 9. “Furnizimi me material për shkeljet e trajtuara në mos administrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare, për shkeljet e trajtuara në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të vlera materiale inventar ekonomike elektrike për ndriçim rrugor” Për monitorimi i ecurisë lejeve ndërtimit dhe lejeve përdorimit, inventarizim i dosjeve, trajtuar në faqet 87-110, 110-225 dhe 269 të Raportit përfundimtar,

5. znj. J.D, me detyrë specialiste pronave në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave, për monitorimi i ecurisë lejeve ndërtimit dhe lejeve përdorimit, inventarizim i dosjeve dhe mos monitorimi i kontratave të aseteve troje ndertës etj, të Raportit përfundimtar, për shkeljet e trajtuara në mos administrimin e vlerave materiale inventar ekonomik dhe AQT të pa përfshira në pasqyrat financiare, për shkeljet e trajtuara në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimi të vlera materiale inventar ekonomik faqet 87-110, 269, 281 të Raportit përfundimtar,

6. Zj. M.D, me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve, në cilësinë e anëtares së NJP, *Për shkeljet e mëposhtme:*

Në tenderat: “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë”, “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Rilindja”, lagjja nr.1 Kavajë”, “Skema ujitëse Peqin-Kavajë, sekondaret Kavajë (rehabilitim i pjesshëm)”, “Furnizimi me ushqime për kopshtin dhe çerdhen”, faqet 110-225 të Raportit.

Masa “vërejtje” për 8 punoniës:

1. z.A.K., me detyrë specialist Pyje dhe Toka bujqësore, për mosmonitorim të kontratave në sipërfaqet pyjore per çlodhje,zona Golem, zaptime të sipërfaqeve pyjore. Plane të mbarështrimit,trajtuar faqe 274 të Raportit përfundimtar,

2. z. O.D., me detyrë specialist agronom i ish-Komunës Golem aktualisht dhe i bashkisë, faqe 281 mos monitorimi i kontratave të aseteve troje ndertës etj, të Raportit përfundimtar, faqe 297, dhe faqet 300 *keq admistrim të aseteve pyje toka, ujra rezervar rëra dhe kontratave me dem ekonomik komuna Golem dhe Bashkia*

3. Z.A.Sh., me detyrë specialist mjedisi, për shkeljet si më poshtë vijon:

- Në tenderin me objekt **“Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë**, në cilësinë e anëtarit të komisionit, në datën 03.06.2016 ka hartuar dhe firmosur procesverbalin në të cilin përcaktohet rritja e sipërfaqes së lagjes së rrugëve nga 85,000 në 165,000 m2 në mënyrë të paargumentuar, duke bërë që kontraktori “A-shpk të përfitoj punë të pakryer.

- Në tenderin me objekt **“Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Synej, Helmas dhe Luz i Vogël”**, faqet 110-225 të Raportit.

4.z. D.K., Përgjegjës i sektorit të ardhurave nga taksat e tarifave vendore.

për shkeljet e trajtuara në administrimin dhe realizimin e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të taksa e tarifa të miratuara me paketën fiskale.

5.Zj.Z.Sh., me pozicion përgjegjëse e njësisë së auditit të brendshëm dhe

6.Zj. F.T., me detyrë specialiste e njësisë së auditit të brendshëm për shkeljet e përbashkëta si më poshtë vijon:

- Nuk i kanë dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi në auditimet e planifikuara dhe të realizuara nuk janë bazuar në vlerësimin e riskut. Nuk janë kryer auditime në fushat me risk, si prokurimet publike, kontratat e dhënies me qira, administrimi i aseteve e tjera të institucionit, debitorët e taksave dhe tarifave vendore, etj. Funksionimi i saj formal ka bërë që gjetjet dhe rekomandimet janë vetëm të karakterit organizativ, jo të nivelit thelbësor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

7.z.D.K., me detyrë Kryeinspektor IMTV Bashkisë, prej majit 2016, për moszbatim të rekomandimeve fq.65 te Raportit përfundimtar ligji 154/2014, ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”.

8.z. I.R., me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake për moszbatim të rekomandimeve fq.65 te Raportit përfundimtar ligji 154/2014.

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 9, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kavajë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave nga **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për **47 punonjësit e mëposhtëm:**

- Masa “Zgjidhje e kontratës të punës”, sipas nenit 10, pika (d), e kontratës së punës, për 2 punonjës si më poshtë:

1. Z. K.Sh., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë dhe në cilësinë dhe detyrë Kryetar Bashkie në funksion i deleguar,si dhe në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në tenderat: “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Rilindja”, lagjja nr.1 Kavajë”, “Skema ujitëse Peqin-Kavajë, sekondarët Kavajë (rehabilitim i pjesshëm), “Shërbimi i pastrimit të qytetit Kavajë, “Shërbimi i pastrimit të Njësive Administrative Synej, Helmas dhe Luz i Vogël”,

